

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE - FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT

УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА - ФАКУЛТЕТ ЗА ЈАЗИЦИ, КУЛТУРА И КОМУНИКАЦИЈА

SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY - FACULTY OF LANGUAGES, CULTURES AND COMMUNICATION

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

**TEMA: ZAKONET E FEJESËS, MARTESËS DHE DASMAVE NË
RRETHIN E PRESHEVËS**

**ЗАКОНИТЕ ЗА ВЕРИДБА, ЖЕНИДБА И СВАДБИТЕ ВО ОКРУГОТ
НА ПРЕШЕВО**

**TRADITIONS OF ENGAGEMENT, MARRIAGE AND MARRIAGE
CEREMONIES IN THE DISTRICT OF PRESEVO**

Kandidati: Enkel Rexhepi

Mentori: Prof. dr. Hamit Xhaferi

Tetovë, Shtator 2018

P a r a t h ë n i e

Presheva, Bujanovci dhe Medvegja si tërësi territoriale etnografike kanë një shtrirje interesante. Pasuria e traditës kulturore shquhet për llojshmërinë e formave, ndër të cilat është edhe martesë si një ngjarje e rëndësishme në jetën e njeriut të ri shqiptar të këtyre trevave. Kjo është baza e krijimeve të familjes dhe si e tillë, në trevën e Preshevës, martesë tradicionale ka normat e saj. Këto norma vijnë që nga kohët e hershme të kësaj treve, duke bërë ndryshime të herëpashershme nga koha në kohë dhe duke iu përshtatur zhvillimit të shoqërisë së trevës në fjalë.

Me anë të institucionit të fejesës dhe martesës, shoqëria e këtushme shqiptare e ka rregulluar me rite e zakone, flasim për martesat me dasmë, dashurinë për jetën bashkëshortore "hapin e madh", duke bërë kalimin nga beqaria në martesë, të vijnë edhe ndjesitë e rrethit familjar e fisnor. Kjo dashuri për jetën bashkëshortore shfaqet furishëm në dasmë, me këngë, valle, rite, lojëra, ushqime të bollshme dhe krahas këtyre edhe detyrime normative. Duket se të gjitha këto së bashku përbëjnë thelbin e martesës tradicionale.

Martesa ka hallkat e veta zakonore që duhen respektuar. Ato e bëjnë martesën të vlefshme edhe pse ajo fillimisht nuk bëhet mbi bazën e ndonjë akti ligjor, duke u celebruar fillimisht nga kleriku i fesë islame e më pas nga organet zyrtare shtetërore. Martesës si të tillë i kushtohet shumë kohë e përgatitje, me shumë përpjekje e shpenzime të mëdha të pa nevojshme. Këtë e dëshmojnë një numër i madh ritesh që e përcjellin zhvillimin e martesës, që nga dhënia e fjalës, vlimit, forcimit ose fejesës dhe deri në dasmë, e cila përmbyll gjithë ciklin e kësaj sipërmarrjeje.

Do të ishte mjaft e këndshme të përfshinin gjithë këtë ritual. Ne do të ndalemi tek disa rite kryesore dhe të hedhim një vështrim të shkurtër mbi zhvillimin e dasmës tradicionale dhe të evidentojmë disa nga elementet më të dallueshëm. Ajo është një eveniment i rëndësishëm në jetën e njeriut.

Organizimi i zgjatur në kohë i këtij ceremoniali dëshmon për rëndësinë që i kushton preshevari martesës, si një etapë e rëndësishme në jetën e njeriut, në të cilën krijohen marrëdhënie të patjetërsueshme. Kjo është një arsye pse ata i japin rëndësi organizimit deri në detaje të ceremonialit të dasmës, e cila është një shfaqje e zgjatur në kohë, e pasur në rite e veprime, çka dëshmon edhe kulturën e gjerë të tyre.

Dasma tradicionale preshevere përfaqëson ritualin nëpërmjet të cilit bashkohen dy njerëz në këtë lidhje të shenjtë, si dhe detyrimin e tyre moral për të përballuar vështirësitë që i presin në të ardhmen. Në tërësinë e saj dasma ka një zhvillim të natyrshëm, një ndërrim brenda një kornize ritualesh të detyruara, një kompozicion artistik, që në qendër ka dy personazhet kryesorë, nusen dhe dhëndrin. Gjithçka vërtitet rreth tyre, por atmosfera që krijohet, "shfrytëzohet" nga të ftuarit për të kënaqur vetveten, për të gëzuar së bashku me të afërmit dhe të njohurit, zgjon dëshirën për t'u larguar qoftë për pak nga monotonia e përditshme.

Fjalë kyçe: Presheva, tradita, zakonet, doket, fejesa, martesë, dasma.

Предговор

Прешева, Бујановци и Медвеѓа како територијална етнографска област имаат интересна продолжување. Богатството на културната традиција се разликува по разновидните форми, вклучувајќи го и бракот како важен настан во животот на младиот Албанец на овие земји. Ова е основа на семејни креации и како такво, во областа Прешево, традиционалниот брак има свои норми. Овие норми доаѓаат од најраните времиња на оваа област, одвреме-навреме се прават повремени промени и се прилагодуваат на развојот на компанијата од засегнатиот регион.

Преку институцијата ангажирање и брак, локалното албанско општество го организираше со ритуали и обичаи, зборуваше за свадбени бракови, љубов за брачниот живот "големиот чекор", со што преминуваше од сингл на брак, семејството и племенскиот круг. Оваа љубов кон брачниот живот изгледа бесмислена на свадбата, со песни, танц, ритуали, игри, изобилство храна и покрај овие нормативни обврски. Се чини дека сите овие заедно го сочинуваат јадрото на традиционалниот брак.

Брак има свои вообичаени врски кои треба да се почитуваат. Тие го прават бракот валиден, иако иницијално не е направен врз основа на кој било правен акт, првично прославен од свештенството на свештенството, а подоцна и од државните службеници. Бракот како таков бил посветен многу време и подготовка, со многу непотребни напори и трошоци. Ова е потврдено од страна на голем број ритуали кои го следат развојот на бракот, бидејќи даваат збор, вриење, зајакнување или ангажирање и се до свадбата, со што се заокружува целиот циклус на овој потфат.

Би било убаво да го вклучите целиот ритуал. Ние ќе застанеме во некои од главните обреди и ќе земеме краток поглед на традиционалниот свадбен развој и ќе нагласиме некои од најпрепознатливите елементи. Тоа е важен настан во човечкиот живот.

Продолжената организација во време на оваа церемонија сведочи за важноста што ја придава на бракот како важна пресвртница во животот на човекот, во која се јавуваат неразделиви односи. Затоа им придаваат значење на организирањето на деталите за свадбената церемонија, што е продолжено шоу во времето, богато со ритуали и дејства, што е потврдено од нивната широка култура.

Традиционалната претходна свадбена свадба претставува ритуал преку кој двајца луѓе се приклучуваат во оваа света врска, како и нивната морална обврска да се соочат со тешкотиите со кои се соочуваат во иднина. Во целост, свадбите имаат природен развој, промена во рамки на присилни ритуали, уметнички состав, центриран на двата главни ликови, невестата и младоженецот. Сè се врти околу нив, но атмосферата што се создава,

која "ја користат" гостите да уживаат во себе, да уживаат заедно со своите роднини и познаници, ја поттикнува желбата да ја напушти или, во помала мера, дневната монотоност.

Клучни зборови: Прешева, традиции, обичаи, обичаи, ангажман, свадба, свадби.

L ë n d a e h u l u m t i m i t

Lënda e hulumtimit në këtë studim janë zakonet e fejesës, martesës dhe dasmave në rrethin e Preshevës. Në qerthullin e kësaj treve nuk mungon lidhja e ngushtë me traditën, zakonet dhe kulturën e hershme që kanë lënë të parët. Në këtë trevë vërehen figura të dy gjinive që universitet kanë pasur vetëm talentin e përvojës jetësore të cilët kanë ngritur lart korifetë e shpirtit njerëzor, ndjenjat e bukurisë shpirtërore, ushqimit të përditshëm. Është vërejtur se në qerthullin e kësaj treve nuk mungon lidhja e ngushtë me traditën, zakonet dhe kulturën e hershme që kanë lënë të parët. Pikërisht është vërejtur universi i këtyre vlerave të këngëve popullore që i kanë kënduar vajzat e reja preshevare. Në këngët e dashurisë që këndohen me rastin e fejesës apo martesës, vërehet leksiku i pastër dhe i qartë, plot frymë, ku vihen në pah simbolet, epitetet, krahasimet dhe metaforat që janë palca e vargjeve të këngës popullore të këtushme. Pra, këta janë këngët të cilat i përkasin këtij komuniteti, ku jeta dhe kultura e të cilëve është lindur dhe rritur në gjirin e popullatës së këtushme ku rrojnë dhe lulëzojnë këngët e dasmave të fejesës dhe martesës, të cilat i dedikohen si vashës ashtu edhe djalit. Duket se këto këngë jetojnë në gojën e këngëtares dhe këngëtarit popullor, duke mbajtur kështu të gjallë traditën dhe artin popullor. Gjatë hulumtimit kemi vërejtur se këngët që i këndojnë vashat apo djemtë, bluajnë përbrenda vetes gjëra të mëdha, punë të bardha, përfytyrime, imazhe, ndjenja dhe virtyte njerëzore, duke i selitur dhe duke i latuar. Thurja e këtyre këngëve kanë të bëjnë kryesisht me kohën dhe fatin e vajzës dhe djalit që fejohej apo martohet, duke u krahasuar me lulet më të bukura të këtij ambienti. Është vërejtur se vashat dhe djemtë e Luginës së Preshevës e më gjerë, janë ushqyer me këngët popullore që në fëmijëri, me humorin e hollë, duke u dhënë këngëve një interpretim shumë origjinal dhe me kulturë. Në këtë mënyrë këngëtari apo këngëtarja popullore duket se këngëve u japin një interpretim shumë origjinal dhe me kulturë. Këta interpretues të këtyre këngëve na duken si vëzhgues të artit me vlera të rralla, duke e pasqyruar sipas mënyrës e stilit jetën me bukuritë, hallet, brengat, zhgënjimet me atë përndritje lotësh vetjakë. Nga ky këndvështrim këngët e tyre

ngjajnë si dy pika loti, sidomos të vashës e cila ndahet nga prindërit e saj, si dy pika vese mbi perlat e trëndafilut që i ka mbjellur dhe rritur në vendlindjen e saj. Ajo që na ka rënë në sy gjatë hulumtimit tonë ka qenë arsyeja që në këtë studim apo vlerësim për krijimtarinë ka saktësi dhe objektivitet me plot jetë e mesazhe. Duket se zgjedhja dhe kalitja e fjalëve është në funksion të mendimit dhe idesë që përcjellin këngët e këtilla që janë uji i pastërtisë shpirtërore. Këto këngë shprehin idenë e virtytit të lartë të harmonisë duke u kënduar me pasion e dashuri të zjarrtë.

Qëllimi i hulumtimit

Vihet në pah këngëtarja dhe këngëtari popullor, si bijë të popullit, si artistë dhe poetë me shpirt që përndrisin në çdo varg metaforat, krahasimet, epitetet nga gurra e pashtershme popullore. Gjetja e fjalëve dhe e shprehjeve të goditura të marra nga përvoja jetësore e popullit. Kjo tregon se kultura e këtij shpirti artistik duket porsigonxhe e paçelur, plot me vesë që na dhuron melodinë e këngës mallëngjyese të tij. Përdorimi me dashuri e plot vlerë i fjalëve të rralla, bujare, plot shen, hakikate, me mejtime, merak dashurie, plot hijeshi, gonxhe nazelie, isharet, lezet, hijeshi-bukuri, kismrt-fat, hasret-inat dhe me ngjyresë emocionale. Kjo këngëtare popullore duket sikur flet apo këndon me origjinalitetin e vet. Këtu fjala dhe shpirti i vashës dhe djalit janë në harmoni të plotë me atë merak e kimet. Duket se këngëtari dhe këngëtarja popullore në krijimtarinë e tyre e respektojnë traditën popullore me seriozitet. Hulumtohen mjetet e rralla, shprehëse që vijjnë natyrshëm e plot gjallëri për të dhënë e harmonizuar gjendjen emocionale të dy të rinjëve. Të tilla si lulja e kujtimit, dallëndyshja gushëbardhë, fëllënxa nazelie, si burbuqe plot me erë, pëllumbeshë buzën në gaz e tjerë. Këngëtarja apo këngëtari popullor i sheh si pjesë e jetës së tyre njerëzore, si vuajtje e lumturi njëkohësisht edhe si dhembje e bukuri. Dy të rinjët duke qenë dashamirës e fisnik, me virtyte e zakone të mira, siç është besa e vajzës e vajzës dhe djalit, bujaria dhe dashuria e tyre. Epiqendra e ligjërimit shpirtëror e dy të dashuruarve është me plot virtyte që duket si një lulishte me trëndafila apo si një parajsë e vërtetë ku mbisundon bujaria e tyre në kopshtin e këngës, në dhënie e fjalës me të gjitha kuptimet e duhura.

Përmes fjalës plot forcë, ngjyrim emocional, duket se tretet dhe shkrihet gjithë burimi krijues me ndjesi e përjetime të rralla personale. Duke i përkundur që të dyja virtytet e larta njerëzore me kryendjenjën e ndjenjave, dashurinë të njeriu me vuajtjet e tij shpirtërore, vargu dhe kënga e tyre del nga vetvetja për t'u shtrirë e përjetuar tek të fejuarit dhe sendërtuar gjatë aktit martesor. Në të gjitha këngët simbolet dhe figurat pasqyrojnë një gjerësi dhe thellësi konceptuale brenda intimitetit shpirtëror. Me emocionet dhe dhembjet duke përcjellë si një llambë magjike dashurinë njerëzore. Duke dëgjuar tekstin e këngës plot ndjenjë, na duket se ndjehemi krejt të lirë duke e shtrirë përjetimin brenda vetes, prej ku zemra këndon. Kënga nuk është as filozofi, as art i të menduarit, por një frymëzim shpirtëror i përjetuar që mallëngjen dëshirat e paplotësuara të kësaj jete.

Presheva si tërësi territoriale etnografike ka një shtrirje interesante. Pasuria e traditës kulturore shquhet për llojshmërinë e formave, ndër të cilat është edhe martesja si një ngjarje e rëndësishme në jetën e njeriut. Ajo është baza e krijimit të familjes dhe si e tillë, në trevën e Preshevës martesja ka normat e saj. Këto norma vijjnë që nga kohët e hershme, duke bërë ndryshime të herëpashërshme nga koha në kohë dhe duke iu përshtatur zhvillimit të shoqërisë shqiptare të kësaj krahine. Me anë të institucionit të

martesës, treva e Preshevës e ka rregulluar me rite e zakone, kuptohet flasim për martesat me dasmë ku dashuria për jetën, shfaqet furishëm në dasmë, me këngë, valle, rite, lojëra, ushqime të bollshme dhe krahas këtyre edhe detyrime normative. Duket se të gjitha këto së bashku përbëjnë thelbin e martesës tradicionale.

Martesa ka hallkat e veta zakonore që duhen respektuar. Ato e bëjnë martesën të vlefshme edhe pse ajo nuk bëhet mbi bazën e ndonjë akti ligjor. Si e tillë i kushtohet shumë kohë e përgatitje, me shumë përpjekje e shpenzime të mëdha. Këtë e dëshmojnë një numër i madh ritesh që e përcjellin zhvillimin e fejesës dhe martesës, që nga dhënia e fjalës, vlimit, forcimit ose fejesa dhe deri në dasmë, e cila përmbyll gjithë ciklin e kësaj sipërmarrjeje. Do të ishte mjaft e këndshme të përfshinin gjithë këtë ritual, por do të ndalemi tek disa rite kryesore duke i hedhur një vështrim të shkurtër zhvillimit të dasmës tradicionale dhe të evidentojmë disa nga elementet më të rëndësishme. Kjo është një eveniment i rëndësishëm në jetën e njeriut ashtu si dhe lindja e vdekja.

Metodat e hulumtimit

Për përgatitjen dhe mbarështrimin e këtij punimi janë përdorur këto metoda:

- 1. Metoda teorike**
- 2. Metoda komparative (krahasuese)**
- 3. Metoda deskriptive**
- 4. Metoda analitike**
- 5. Metoda sintetike**
- 6. Metoda historike**

R ë n d ë s i a e p u n i m i t

Fejesa, martesë dhe dasmat janë pjesë më e rëndësishme në jetën e njeriut, respektivisht djalit dhe vashës së kësaj treve, të cilët si individë dhe rreth shoqëror gjatë hyrjes në martesën bashkëshortore arrijnë të formohen si nga aspekti moral, ashtu edhe nga ai shpirtëror dhe njerëzor. Andaj rëndësia e këtij punimi do të jetë si motiv ideja, vullneti dhe transformimi i tyre në rethin bashkëshortor.

Martesa në traditën popullore shqiptare është konsideruar nga zakonet më të dëshiruara, një zakon gëzimi, ngase ka sublimuar kalimin e disa fazave të jetës deri në pjekurinë për punë e jetë dhe, mbi të gjitha, për shumim. Këtij zakoni familjar i paraprijnë rritja e suksesshme e fëmijës së shëndoshë dhe të përgatitur për jetë, kalimin në fazën e pjekurisë për martesë (iniciacion), - për fejesën dhe vetë aktin e martesës. Martesa në traditën popullore shqiptare është konsideruar gjithmonë ndër zakonet më të dëshiruara, një zakon gëzimi, ngase ka sublimuar kalimin e disa fazave të jetës deri në pjekurinë për punë e jetë dhe, mbi të gjitha, për trashëgimi me djemë dhe me vajza. Këtij zakoni familjar i paraprijnë rrita e suksesshme e fëmijës së shëndoshë dhe të përgatitur për jetë, kalimin në fazën e pjekurisë për fejesën dhe vetë aktin e martesës. Fejesa si akt ceremonial, që përcakton publikisht personat që, pas martesës, do të

krijojnë jetën bashkëshortore.

Fejesa si akt ceremonial, që përcakton publikisht personat që, pas martesës, do të krijojnë jetën bashkëshortore. Si e tillë, fejesa është e mbushur me plot veprime e ceremoni rituale, disa të trashëguara nga lashtësitë e mugëta pagane, po disa më të vona - edhe me rite islame, në varësi nga besimi. Sipas traditës, është bërë me shkuesi, por më përpara ishte traditë më pak e rastësishme edhe fejesa në bark dhe fejesa në djep, raste këto të trashëguara nga traditat pagane paraislame. Në të dy rastet, bëhej nga pjesëtarët e familjes: babai, nëna, i zoti i shtëpisë e, më rrallë, e zonja e shtëpisë, por vetëm në raste kur dëshirohej të trashëgohej miqësia e mirë e dyanshme, ose shoqëria e fortë në luftë e dy burrave, po edhe e nënave, të njohura në ditë gëzimesh e hidhërimesh, ndenjesh apo të punës – me pëlqimin e dyanshëm, pa marrë parasysh se cili do jetë marrës e cili dhënës. Si e tillë, fejesa është e mbushur me plot veprime e ceremoni rituale, disa të trashëguara nga lashtësitë e mugëta dhe disa më të vona, me rite islame a të krishtera, në varësi nga besimi. Sipas traditës, është bërë me shkuesi. Kjo traditë tashmë ka përfunduar, me përjashtime të ndërhyrjeve më tepër formale, nga ndonjë i afërm ose shok, në rolin e mësimit, pasi që çifti i ri të ketë vendosur për jetë bashkëshortore. Në të dy rastet, bëhej nga **pjesëtarët e familjes: babai, nëna, i zoti i shtëpisë e, më rrallë, e zonja e shtëpisë, por vetëm në raste kur dëshirohej të trashëgohej miqësia e mirë e dyanshme, ose shoqëria e fortë në luftë e dy burrave, po edhe e nënave, të njohura në ditë gëzimesh e hidhërimesh, ndenjesh apo të punës – me pëlqimin e dyanshëm, pa marrë parasysh se cili do jetë marrës e cili dhënës.**

Kjo traditë tashmë ka filluar të zbehet, me përjashtime të ndërhyrjeve më tepër formale, nga ndonjë i afërm ose shok, në rolin e

mësitit, pasi që çifti i ri të ketë vendosur për jetë bashkëshortore. Akti përfundimtar i martesës është dasma (në shtëpinë e dhëndrit) dhe kanaxheçi (në shtëpinë e vajzës). Në të dy rastet këtë gëzim e organizojnë burrat, sipas traditës, por edhe femra është pjesëmarrëse aktive, sidomos në punët që u përkasin grave. Dasmat tradicionale zgjatnin tri ditë e net dhe organizoheshin për të marrë nusen ditën e hënë ose të enjte. Të marteve martoheshin të vejat, me më së shumi 7 krushq. Në kohën tonë po thuajse nuk veprohet kështu. Të gjitha ditët e javës janë dhe ditë dasmash.

Stinët më të parapëlqyera të traditës për martesë kanë qenë vjeshta dhe pranvera, një traditë tashmë e tejkaluar – dasmat bëhen gjatë gjithë vitit. Dasma tradicionale është organizuar në shtëpinë e dhëndrit, dhe **këanaxheçi** në shtëpinë e vajzës. Tash dasmat organizohen në lokale publike, ku marrin pjesë burra e gra. Fatkeqësisht, ka raste të shpeshta, që përbëjnë një gabim gjykuar në aspektin islam, që të marrin pjesë bashkërisht burra e gra, ndonëse, sipas traditës, organizoheshin në hapësira të ndara. Tash nga kërkesa të shumta për lokale dhe muzikantë, caktimi i datës së dasmës detyrohet nga këto dy mundësi: sipas orarit që caktojnë muzikantët dhe pronari i lokalit.

K r e u I

Hyrje

Shekuj me radhë tradita jonë popullore e mbrojtë me ngulm vetëqenien nga infiltrimi i ndikimit të kulturave të tjera. Këtë gjë e dëshmojnë format e lashta, të cilat u ruajtën në vazhdimësinë e pandërprerë të tyre deri në fund të shekullit të kaluar. Përveç tjerash, ato ndihmojnë në hetimin apo veçimin e elementeve autoktonë dhe origjinalë, jo vetëm të krijimtarisë sonë muzikore në veçanti, por edhe të krijimtarisë shpirtërore popullore, në përgjithësi.

Jo rastësisht për karakteristikat muzikore të kësaj ane thuhet se nga kohërat të mëhershme ka mbetur traditë kulturore muzikore, bile edhe greku Tukitid, trekëndëshin ndërmjet Kumanovës, Gjilanit dhe Preshevës e quajti ana më muzikale në Ballkan. Gjatë shekujve, popullata shqiptare e Preshevës me rrethinë, me vështirësi të mëdha ruajti dhe u mundua të kultivojë traditën e saj të kulturës popullore, e sidomos ritet e dasmës shqiptare dhe vallet e burrave, të cilat luheshin në dasmat shqiptare të Preshevës me rrethinë.

Një ndër elementet më pozitive në letërsinë popullore është edhe tradita e dasmave, e cila gjatë shekujve ka pasur ndikim dhe zë vend të posaçëm në jetën e të rinjve. Si të gjithë popujt e rruzullit tokësor edhe te ne shqiptarët, dasma i ka doket e zakonet e veta. Edhe pse këto, në fillim na duken se janë të njëjta, prapëseprapë ato ndryshojnë prej vendit në vend dhe prej kohës në kohë. Shumica e formave të njëjta si të folklorit muzikor apo edhe të traditave në doke dhe zakone nga vise të ndryshme, te shqiptarët në përgjithësi, kanë elemente të përbashkëta. Varësisht nga pozita gjeografike e vendit dhe, pjesërisht, nga niveli i zhvillimit kulturor e historik, ato dallohen për nga dinamika evolutive e zhvillimit të tyre të përgjithshëm. Shumica e elementeve karakterizuese së tradicionales muzikore të shqiptarëve janë ruajtur, gjithashtu, edhe në këngët lirike të dashurisë dhe në

këngët e dokeve, të zakoneve dhe të riteve të ciklit të dasmës.

Në këtë punim janë shtjelluar elementet karakterizuese të dasmës tradicionale në rrethinën e Preshevës në doket, zakonet dhe folklorin muzikor shqiptar të kësaj ane. Theksohen format me elemente të traditës së vjetër që janë: **këngët e fejesës, këngët e mesitit, këngët e traditës , baladat, këngët epike legjendare, këngët dhe vallet e dasmave, riteve dhe zakoneve të ciklit të dasmës, këngët shpotitëse** etj.

Pika kyçe e orientimit ishte bërja e pyetësorit pasi që për Luginën e Preshevës nuk kemi lëvrim të këtij lëmi. Ishin vetë informatorët, që bisedë pas bisede, pyetje pas pyetjeje jepnin të dhëna të frytshme nga traditat tona dasmore. Informatorët i kemi pasur të profesioneve të ndryshme, si bujq, punëtorë, shtëpiake, mësues, studentë, nxënës etj. Zakonisht për këngët e dasmave, pos grave, më kanë ndihmuar shumë, edhe disa nxënës të shkollave dhe studente. Pasi, mbledhjen e materialit e kemi filluar para disa vjetësh, kështu që disa informatorë më nuk janë ndër të gjallët dhe më gëzon fakti që ata ishin, në njëfarë mënyre, kontribues në hapat e mia shkencore.

Për ta kuptuar më mirë, ne i kemi trajtuar doket dhe këngët e dasmës në dy rrafshë, në këngët dhe zakonet që i hasim në dasmën e djalit dhe në ato të vajzës. Pastaj kemi folur për ceremonitë në dasmën e burrave dhe ceremonitë te gratë. Gjithashtu kemi bërë ndarjen e dokeve dhe këngëve të fejesës e të dasmës, bile kemi shkruar edhe për karakteristikat e netëve të ndryshme të dasmës.

Kemi shkruar edhe për rastin, kur vajza që shkon nuse nuk është e virgjër. Disa të dhëna i kemi dhënë edhe për ceremoninë e të shkuarit dhe ardhjes së “Babxhyshit”. Duke i pasur parasysh të gjitha këto pika që cekëm më lart, lirisht mund të themi se kontributi i bashkëpunëtorëve tanë nuk ka qenë i vogël dhe se rrumbullakimi i kësaj teme do të jetë një material shumë i nevojshëm për studiuesit e mëvonshëm.

K r e u II

POZITA GJEOGRAFIKE E KOMUNËS SË PRESHEVËS

Për ta kuptuar më mirë, po i japim disa të dhëna për pozitën gjeografike të Preshevës. Komuna e Preshevës me një sipërfaqe prej 264 km, përfshin fushën e Preshevës në mes, pjesë të malit të Karadakut në perëndim dhe të malit Rujn në lindje. Fusha e Preshevës përfshin rreth 37.8%, Karadaku 45.4% dhe Rujni 16.6% të territorit të përgjithshëm. Relacioni fushë - mal është 37.8% me 62.0.

Fusha e **Preshevës**, në veri është e lidhur morfologjikisht me fushën e **Bujanocit** e në jug, nëpërmjet të Kërruses së njohur të Preshevës, me fushën e Kumanovës. Mali Karadak shtrihet në perëndim, në mes fushës së Preshevës dhe të Gjilanit, me një varg majash shumë të bukura, nga të cilat sidomos, dallohet Ostrovica me lartësi prej 1168 metrave, që paraqet majën më të lartë në territorin e Komunës. Maja e Madhe (1034 metra) mbi Preshevë, Kodra e Peçenës (977 metra) etj.

Në **Karadak** është zhvilluar relievi karstik, ku gjenden dy shpella të bukura : **Shpella e Ilincës** dhe Shpella e Arushës (**Tërnavës**). Në lindje të fushës së **Preshevës** shtrihet Rujni, me majën më të lartë - Kodrën e Tukashit (807 metra).

Fusha e Preshevës është e zgjatur në drejtim veri- jug, në gjatësi prej 17 km dhe gjerësi maksimale prej 8 km. Në këtë fushë shtrihet Kërrusja(ujëndarësja e ulët) e njohur e Preshevës, me lartësi mbidetare prej 460 m, që shtrihet në drejtim lindje- perëndim. Pika më veriore e fushës është në lartësi mbidetare prej 405 m, ndërsa pika më jugore në lartësi prej 390 m. Kjo kërruese ka rëndësi të madhe komunikative nga se lidh dy luginat e mëdha, të Moravës dhe të Vardarit, të cilat

paraqesin luginë të madhe me shtrirje për së gjati Siujdhesës Ballakanike. Nëpër këtë kërruese kalon hekurudha dhe rruga kryesore automobilistike, të cilat lidhin [Detin Egje](#) me [Fushën e Panonisë](#).

Klima e Komunës së Preshevës është e mesme kontinentale. Për shkak të morfologjisë dhe lartësisë së ndryshme mbidetare ekzistojnë ndryshime klimatike ndërmjet fushës dhe pjesëve malore, sidomos të Karadakut. Fusha e Preshevës merr diç mbi 600 mm, mesatarisht, të reshura në vit. Në të fryjnë erëra veriore dhe jugore. Pjesa në jug të Kërrusës, e kthyer kah jugu, ka klimë pak më të butë se sa pjesa veriore, pa e kthyer kah veriu. Shpeshherë bora mbulon vetëm këtë pjesë. Njësoj është edhe me mjegullën. Nganjëherë mjegull ka vetëm në jug të Kërrusës. Pjesa malore ka klimë më të ashpër, sidomos [Karadaku](#), ku temperaturat janë më të ulta, bora është dukuri më e shpeshtë dhe me trashësi deri 80 cm. [Karadaku](#) e godet më shumë breshëri, sidomos pjesën e saj jugore. Në të mjegulla është më e shpeshtë, por nganjëherë në pranverë dhe vjeshtë, me rastin e temperaturave inverzare, mjegulla është dukuri vetëm për Fushën e Preshevës (Dr. Jahi Murati).



K r e u III

DISA TË DHËNA PËR HISTORIKUN E KOMUNËS SË PRESHEVËS

Komuna e Preshevës shtrihet në kulmin (Kërrusën e Preshevës) e Lugnajës së Moravë-Vardarit, ku lidhen këto dy lugina të mëdha, të cilat për së gjati, në drejtim veri- jug, përshkojnë Siujdhesën Ballkanike. Udha e vjetër, në drejtim lindje-perëndim, kryqëzohet në Fushën e Preshevës. Pozita e Komunës në qendër të Siujdhesës Ballkanike dhe në Lugnajën e Moravë-Vardarit, përpos rëndësisë strategjike ka pasur edhe rëndësi të madhe ekonomike dhe kulturore. Kështu, qysh nga kohërat më të vjetra- antika dhe mesjeta, territori i kësaj Komune ishte i banuar dhe jeta në të kurrë nuk është ndërprerë. Këtë më së miri e dëshmojnë gjetjet e shumta arkeologjike dhe numri i madh i rrënojave të kështjellave iliro- shqiptare, më vonë të rindërtuara nga romakët.

Presheva për herë të parë përmendet më 1381. Ndërtimi i hekurudhës së parë (më 1888) edhe më shumë shtron rëndësinë e kësaj komune. Këtë rëndësi e rrit edhe ndërtimi i rrugës automobilistike paralele me hekurudhën (më 1963). Në vitin më 1979 Presheva lidhet me Gjilanin, me rrugë të asfaltuar, e cila shfrytëzon Qafën e Livadhit të Shehut dhe Muçibabën.

Banorët e parë vendas në antikë, në këtë trevë, ishin të parët tanë-ilirët, përkatësisht fisi ilir-dardanët. Më vonë, për shkak të pushtimeve të njëpasnjëshme të popujve të ndryshëm, ndryshohet struktura etnike, por kurrë nuk zhduket rrënja iliro-shqiptare. Ajo në antikën e vonshme dhe në mesjetën e hershme, me siguri, ka ekzistuar, përkundër romanizimit të popullsisë iliro-shqiptare. Edhe gjatë periudhës bizantine dhe mesjetës serbe në territorin e Komunës së Preshevës, përkundër sllavizmit intensiv, etnikumi iliro-shqiptar vazhdon të ekzistojë deri në ditët tona. Pas ardhjes së turqve në trojet shqiptare është ndaluar procesi i sllavizmit të shqiptarëve, por ka filluar myslimanizmi i vrullshëm i tyre. Megjithëkëtë në disa fshatra të Karadakut deri vonë është ruajtur feja katolike. Pas luftës serbo-turke (1876-1878) në territorin e Komunës së Preshevës vendoset një numër i shqiptarëve (muhaxhirëve) të ikur nga trevat e Vranjës dhe të Toplicës. Pas luftërave ballkanike, Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore një pjesë e shqiptarëve të këtushëm, për shkak të trysnive politike, fetare dhe ekonomike, shpërngulet për në Turqi.

Të dhënat historike dëshmojnë se territori i Komunës së Preshevës gjithmonë dhe pandërprerë gjeografikisht-historikisht dhe në pikëpamje kulturore ishte Kosovë. Edhe pas disa vjetëve të krijimit të krahinës së Kosovës (më 1945) Karadaku (nëntë fshatra të tij) i takonin Kosovës. Para Luftës së Dytë Botërore, Presheva ishte qendër e rrethit e në këtë kohë është qendër komunale.

K r e u IV

Demografia e Preshevës

Viti	Serb	%	Shqiptar	%	Total									
1961	6,741	25.21%	18,229	68.18%	26,738									
1971	5,777	19.22%	23,625	78.60%	30,057									
1981	4,204	12.38%	28,961	85.31%	33,948									
1991	3,206	8.23%	34,992	89.85%	38,943									
2002	2,984	8.55%	31,098	89.10%	34,904									

Komuna e Preshevës ka një popullsi shumicë shqiptare që flasin dialektin gegë dhe popullsinë serbe pakicë që flasin dialektin Torlak. Përqindja e popullsisë shqiptare në Preshevë është mbi 96 % që njëherit e bën qytetin me më shumë shqiptarë në Serbi. Banoret e Preshevës janë kryesisht me fe islame. Shumica e fshatrave janë shqiptare, përveç fshatrave: Lanik, Svinisht, Savojec, Cakanoc dhe Mamicë, ku serbët janë shumicë. Gjithashtu, shumë fshatra kanë përbërje prej 99 % shqiptarë si: Rahovicë, Miratoc, Geraj, Norçë etj dhe fshatrat që janë etnikisht të përziera si: Bushtran, Golemidoll, Leran, Strezoc, Ternavë, Çukarkë dhe vetë qyteti Preshevë.

K r e u V

ZAKONET E FEJESËS, MARTESËS DHE DASMAVE NE RRETHIN E PRESHEVËS

Dasma është një akt shumë i gëzueshëm që familjarizon dhe njëkohësisht bashkon dy të rinj. Zakonisht, në trevën e Preshevës, martesat janë bërë relativisht në një moshë të re. Për aktin e martesës së dy të rinjve, më herët, kryesisht kanë vendosur prindërit e tyre, pra kanë vendosur duke mos i pyetur fare as djalin as vajzën. Mosha relative e fejesës së vajzës është që nga 15 - deri në 20 vjeçe, ndërsa mosha e djalit duhej të ishte 17 - 22 vjeç. Në rast se djali e kalonte moshën 25 e vajza 22 vjeçare, atëherë llogaritej se i ka kaluar mosha e martesës. Në moshën 15 vjeçe vajzat i mbulonin me çarçafë, sepse ato më kanë hyrë në të ashtuquajturin "bylyk", pra kanë arritur moshën e martesës. Kjo ishte mosha ideale për martesë, por ka pasur edhe raste, kur si djali, ashtu edhe vajza kanë pasur moshë edhe më të vogël, pra moshë minore. Në Luginë gjithmonë janë munduar që martesat të bëhen ndërmjet fshatrave më të afërt, sepse "miçasia e ngatë s'ka të pagueme...". Njerëzit e Luginës gati njihen të gjithë njëri me tjetrin, kështu që edhe miqësia në mes tyre është më e lehtë dhe më e preferuar.

Kjo, pra është **mosha e fejesës**, gjegjësisht e martesës, mirëpo përgatitjet janë bërë edhe më herët. Sidomos kur ishte ndonjë djalë hasreti, dëshiri, vëlla i vetëm i shumë motrave, atëherë këngët për martesën e të vëllait fillojnë shumë më herët. Me këtë rast, motrat, vazhdimisht këndojnë këngë për vëllanë e tyre shumë të ri. Duhet theksuar se motrat gjithnjë me anë të këngëve imagjinojnë dhe ekspozojnë martesën e vëllait me të gjitha të mirat.

Kryesisht në këtë trevë, **fejesa** është bërë nëpërmjet të një **mesiti**. Mesiti është një ndërmjetësues, që i njeh të dyja familjet, si të vajzës ashtu edhe të djalit. Ka raste që mesiti këtë e ka pasur edhe si profesion. Rëndom për punët e kryera ka kërkuar, nga shtëpia e djalit edhe para, madje në të shumtën e rasteve edhe lira ari. Në raste të rralla, kur ndonjë djalë ka mbetur pa martuar, familja e tij publikisht ka thënë se për mësitni japin një ose dy lira ari.

Mësiti është përpjekur, që përafërsisht, si djali ashtu edhe vajza të jenë të një niveli, madje ai është përpjekur që edhe familjet t'i përshtaten njëra - tjetrës. Mirëpo ka pasur raste, kur mesiti për shkaqe materiale nuk ka qenë edhe shumë i ndërgjegjshëm.

Anëtarët e familjes së djalit, kur kanë parë diku ndonjë vajzë të mirë të një familjeje të njohur kanë biseduar për këtë në shtëpi. Kështu familja e djalit pajtohen dhe vendosin paraprakisht që ta gjejnë shkuesin (mesitin) e duhur për t'ia thënë këtë familjes së vajzës. Më së shumti për mesitin është zgjedhur daja i vajzës, apo ndonjë i njohur tjetër.

Pasi është caktuar personi i duhur për mesit, ai shkon në shtëpinë e familjes

së vajzës si mysafir. Shpesh prindërit e djalit për mesit e zgjedhin ndonjë njeri të ndershëm dhe me virtyte të larta njerëzore, sepse fjala e tij ka peshë dhe luan rol të rëndësishëm. Nganjëherë edhe autoriteti i mesitit kryen punë, sepse s'mund të kthehej prapa pa kryer me sukses rolin e mesitit.

Mësiti në fillim e ka pak si të vështirë për ta hapur çështjen për të cilën ka vajtur në shtëpinë e vashës . Por janë disa shenja paralajmëruese sidomos në dimër, ku mesiti merr mashën dhe e përzien prushin në mangall, gjë që është një paralajmërim se ka ardhur me punë, pra si mesit. Kështu mesiti shfrytëzon mungesën e vajzës dhe fillon me fjalët duke thënë se unë sot tek ju, në këtë shtëpi kam ardhur pak si me punë. Pra, familja e "filan fistekut ju ka pëlçy për mik dhe kërkon për nuse çikën e juve". Pastaj fillon të flasë për familjen e djalit, për pasurinë e tyre dhe në tërësi për personalitetin e djalit etj. Ai përpiqet që mos të harrojë asgjë, tregon fill e për pe për gjithë pasurinë që kanë, si për tokë e shtëpi, ashtu edhe për kafshët. Tregon hollësisht për anëtarët e familjes e më gjerë, madje tregon edhe se ku dhe kë i ka dajë. Gjithsesi rrëfen edhe për dhëndrin, si për hije, ashtu edhe për fije.



Natyrisht, familja e vajzës edhe nëse i pëlqen, përsëri mbrohen dhe mundohen të shtiren si të pa interesuar, me motivacionin kinse vajza është e re dhe se do të mendohemi pak për këtë e tjerë. Kështu mesiti, pas disa bisedash kërkon leje duke u larguar nga shtëpia e vajzës dhe duke u thënë atyre që të pyesin e të mendohen mirë dhe prej këtu shkon në familjen e djalit duke e informuar në hollësi me bisedat që ka zhvilluar dhe me rrethanat e krijuara, në të cilën kishte rrjedhur kjo mësitni. Nga ky moment në familjen e vajzës fillojnë interesimet dhe mbledhja e informatave rreth personalitetit të djalit dhe familjes së tij, ku pyetjet rrjedhimisht pozicionohen në kushtet ekonomike, bujarinë familjare etj. Madje ata

interesohen edhe për dajallarët e dhëndrit etj. Ndërkohë puna e mesitit tani është një vazhdimësi rrjedhëse në qarkullimin në të dyja familjet për të deshifruar mendimet e familjes së vajzës dhe të djalit.

Familja e vajzës tani ka një barrë më të madhe sepse gjatë gjithë kohës fillon edhe konsultimet me rrethin e ngushtë e të gjerë familjar, madje këtu duhet të pyeten edhe dajallarët e vajzës, ku edhe ata duhet të japin mendimin e tyre përfundimtar rreth kësaj çështjeje, se a mund të lidhin krushqi me familjen në fjalë. Pasi mbledhin mjaft të dhëna, prindi i vajzës këtë çështje shqyrtojnë me farefisën, se ndoshta dikush nga familjarët mos ka ndonjë zënkë me njerëzit e dhëndrit. Pasi të sqarohen këto punë, e lajmërojnë mesitin dhe e caktojnë edhe ditën se kur duhet që të vijë për ta marrë dorën (fjalën e fejesës). Për të gjitha këto gjëra shkuesi e lajmëron familjen e djalit .

Mjerisht rreth gjithë kësaj situate fare pak, ose më mirë të themi aspak, si vendimmarrës nuk janë dhe nuk pyeten dy të rinjtë që do të lidhen, pra vajza dhe djali. Në disa familje më patriarkale s'pyeten as nëna e as ndonjë femër tjetër. Ja një shembull shumë karakteristik, që na e rrëfeu profesori Sami Agushi, që ka ndodhur në fshatin Miratoc. Një të shtune, ditë pazari, në Preshevë, një mik i thotë babait të vajzës, se do të vijë mesit për vajzën e tij për në fshatin Vaksincë. I ati i vajzës i tha se për këtë punë s'ke çka vjen. Kur u kthye në shtëpi, duke biseduar në familje, foli edhe për bisedën që e kishte bërë me atë presonin. Derisa, ky flet, ndërhyjnë nëna e vajzës, duke thënë, se kurrë nuk e jap tek ai “guri mavit” në Vaksincë. I shoqi, kur i dëgjon këto fjalë, e shan gruan dhe për inati të saj, thotë shko thirrë mesitin, se po ia japim vajzën. Ashtu si tha edhe u bë. Kështu pra, në të kaluarën, pati edhe raste të tilla. Fatmirësisht këto ishin raste shumë të rralla.

Nga çasti i marrëveshjes, si në familjen e djalit, ashtu edhe në atë të vajzës fillojnë përgatitjet e duhura tradicionale rreth fejesës. Në shtëpinë e djalit bëhen gati për ditën e shpalljes së fejesës. Lajmërohen miq dhe dashamirë të familjes. Më pas fillojnë edhe me blerjen e gjërave të ndryshme rreth ceremonisë së parë, që siç thuhet që të mos koritemi. Në këtë shtëpi në të katër anët fillon të mbizotërojë gëzimi e hareja festive. Gjithashtu edhe në shtëpinë e vajzës përgatiten për këtë ditë të shënuar. Thirren disa të afërm e dajallarë. Gëzimi dhe pikëllimi gjejnë një lloj gërshetimi, pra ndjehet një dhembshuri ndaj vajzës.

Në orët e paradites ia mbërrin mesiti vetëm, ose i shoqëruar nga një apo më shumë persona tjerë. Pas uljes në tryezën e familjes ai përsëri fillon dhe hap bisedën se ka ardhur me punë dhe u thotë se N N e kërkon vajzën tuaj për djalin e tyre. Pas disa bisedash, të gjithë të pranishmit çohen në këmbë e njëri më i moshuar dhe i respektuar i familjes së vajzës çohet dhe i thotë se : “Pasi Filani na ka pëlqye si mik, pra edhe ne e pëlqejmë, “pasi Zoti ja paska dhonë po ia japim edhe ne, pra ja pafte hajrin.” (Kjo ceremoni bëhet edhe në gjuhë arabo-turke) Ulen

mesiti e merr “dorën” dhe vazhdojnë bisedë, por tash janë më të lirë. Të tjerët këtë rit e përjetojnë edhe mirë edhe keq , sepse një vajzë pas kaq shumë vjetëve do ta largojnë nga shtëpia.

Në vendin tonë është zakon që kur ta japin (fjalën) vajzën mesitit dhe të pranishmëve u shtrohet edhe drekë edhe atë i ofrojnë “karelanë” (kryelanë) një pite që gatuhet apostafat për fejesë të vajzës. Pasi drekojnë mesiti e merr lejen dhe bohçen, që praktikohet si një lloj shenje për familjen e djalit. Shpesh mesitit ia japin edhe një kofër (valixhe) me disa dhurata për dhëndrin dhe anëtarët e familjes. Nganjëherë, menjëherë pas ceremonisë së dhënies së dorës ndonjë djalë i ri shkon në shtëpinë e dhëndrit dhe ua sjell sihariqin (myzhden). I zoti i shtëpisë këtij çuni i jep edhe të holla. Ndodh shpesh që para fejesës jepet “ikrari” dmth. fjala se këtë ditë do ta shpallim fejesën. Mirëpo, ka ndodhur edhe pse është dhënë “ikrari”, kur ka ardhur dita nuk është mbajtur fjala.

Mësiti me ndonjë tjetër, nisen për në shtëpinë e dhëndrit. Nganjëherë, me vete e merr edhe ndonjë person të familjes së nuses. Familja e dhëndrit dalin dhe i presin të gjithë të gëzuar. Aty ka gëzim të madh. Motrat, mbesat dhe vajzat tjera fillojnë e këndojnë. Mesiti ulet në krye të dhomës më një krenari të madhe. Të gjithë e shikojnë vetëm atë. Dikur ai çohet e merr bohçen dhe më plakut të familjes së djalit ia dorëzon bohçen, ku thuhet ia bën” teslim”. Edhe këtu përafërsisht thuhet të njëjtat fjalë si në ceremoninë në shtëpinë e vajzës, se a e ke “kabull” vajzën e Filanit për djalë... Pasi përfaqësuesi i familjes së dhëndrit pohon se vajzën e pranojnë për nuse për djalin dhe kështu kryhet pranim - dorëzimi i “Dorës”. Bohçen e dhuratat çojnë te gratë. Një i ri i kënaqur me nënë e baba e hap valixhen me dhurata , ku një dhuratë është edhe për të. Pasi të bëhet “teslimi”, kris pushka dhe buçet shtëpia nga kënga. Krisja e pushkës lajmëron fejesën, gjë që është edhe ftesë për në petulla. Këtu vijnë njerëzit “thirr e pa thirr”.

Vajzat fillojnë këngët e tyre duke ia dedikuar **mesitit**. Ato nëpërmjet këngëve na bëjnë me dije se familja e dhëndrit është e dëgjuar dhe se me shumë lehtësi e kanë gjetur nusen. **Është thjesht një trajtesë mbi vlerën ndikuese të folklorit burimor të trevës në fjalë. Dhe ja si përshkruhet në mënyrë gjeniale në kënguen: Na ka ardh ni dorë** (Rahovicë, Preshevë).

Na ka ardhë ni dorë.

Na ka ardhë kollaj

Si me kput ni mollë.

Si me kput ni mollë,

O prej rremit.

Kishte pasë nafakë, o e bija çenit...

Siç po shihet, familja e nuses nuk kursehet fare, madje edhe babanë e nuses e quajnë qen. Pastaj **këngës i vijnë në ndihmë shpjegimet e kursyera deri në magjepsje:**

Jena konë tu nejtë nër ni hije,
Na ka ardhë ni dorë hiç pa dije,

Vajzat s'ndalen fare, vazhdojnë këngët me lëvdata për familjen dhe shtëpinë e dhëndrit. **E rëndësishme është që kënga rrjedh e nuk shteron kurrë si ujët e kulluar nga gurra popullore e kësaj treve** si p.sh.: **Oj Lulja jonë** (Norçë, Preshevë)

Oj lulja jonë, lulja verës,

Rekë e bunar para derës,
Rekë e bunar, xhami e mektep.
Kush na ka inati ishalla pëlset,
Ishalla pëlset si kokrra krypës ,

Nusja e Agimit si yll i dritës.

Nëpërmjet të këtyre vargjeve, na e paraqesin se kjo shtëpi, s'heq për ujë, pasi pos që e kanë lumin pranë shtëpisë, e kanë edhe pusin para derës. Gjithashtu vërejmë se shtëpinë e kanë afër xhamisë dhe mejtepit. Këtu shohim se kënga është kënduar herët, domethënë. Ende para hapjes së shkollave shqipe, pra kur funksiononin mejtepet. Pastaj, në këngë thuhet se: **kush të na ketë inati le të pëlcase.** Sepse **nusja jonë është e bukur si yll drite.**

Si gjithkund edhe në Preshevë, këngët që i dedikohen mesitit janë plot **humor**, e nganjëherë kalojnë edhe në **sarkazëm**.

Hyni Msiti (**Rahovicë, Preshevë**)

Hyni msiti n'der t'oborrit
Kish musteçët si t'maçorrit
Hyri mësiti n'kapixhik
Ish i vogël si pinik.

Pra, ato me një humor të veçuar duke përdorur më tepër shpoti sesa **sarkazëm** vazhdojnë këngët e tyre. Ani shka ka msiti (**Miratoc, Preshevë**)

Ani shka ka msiti ç'i osht vonu,
I kish pasë pantollet pa harrnu,
Ku e ku e kish pasë at të shkretën gru?
Kish dalë n'mahallë me kërku.

Sipas zakoneve patriarkale shqiptare, gruaja duhet të rrijë në shtëpi dhe të kujdeset për burrin dhe fëmijët. Gruaja që kërkon nëpër komshi nuk pëlqehet, andaj edhe e shoqja e mesitit nuk shikohet me sy të mirë, sepse burrit nuk ia ka harruar (qepur) pantallonat.

Kështu mesiti s'kursehet fare dhe vazhdimisht atë e thumbojnë, si: **Po na vjen msiti xhadës s'vjetër (Preshevë)**

Po na vjen msiti ani xhades s'vjetër,
Ani koka metë pa kmishë e pa setër,
Po na vjen msiti kryet si kungull,
Ani po pisket si gusa n'mjegull!

Ndodh që mesiti me apo pa qëllim e vonon dhënien e dorës (testimin), atëherë vajzat ua thonë këngës, si: **Ani msitin tone e ka zone sheqeri (Zhunicë, Preshevë)**

Ani mesitin tonë e ka zonë sheqeri,
Ani S'din me dhonë dorën teveqeli.

Kështu ato të mllefosura vazhdojnë të këndojnë edhe me vargje shpotitëse:

Ore msit, o kryet si kepë,
Kshyri tirçit se t'u paskan shkepë.

Pastaj, nëpërmjet të kësaj kënge vajzat tregojnë bujarinë e familjes së dhëndrit se shumë lehtë e kanë fejuar vëllanë e tyre, pra s'e kanë lutur askënd... Pastaj vazhdojnë: Në një tjetër këngë thuhet: **Mesiti jonë ka bo poterë (Kurbali, Preshevë)**

Mësiiti jonë ka bo poterë,
Ka shti gishtin e po vjell.

Mos ke xhet, o mësit noj kime,
E korite o ket shpinë teme.
– S'xheta xho, asgja nuk dita,
Hongra shumë e u korita.

Derisa **në shtëpinë e vajzës si simbol i fejesës së vajzës është kryelana**, te **shtëpia e djalit ndryshon simbolika e gatimit aty gatuhen dhe servohen petulla**. Pra, simboli i fejesës në shtëpinë e djalit janë petullat. Në të shumtën e rasteve haset edhe thënia që i drejtohen më të vjetrit beqarëve se kur do të hamë petulla tek ti, dmth. Se kur do të fejojesh. Shtëpia gjatë këtij akti festues është e mbushur me miq e dashamirë, të gjithë shërbehen me petulla, djathë, ullinj, çaj, mjaltë e ëmbëlsira tjera.

Ore msit...(Shoshajë, Preshevë)

Ore msit he dërvish
A do pite a do mish
As du pite as du mish
E du lirën hic pa prishë.

Ndodh që edhe mesiti rri shumë, atëherë vajzat kanë vargje edhe për këtë situatë, si p.sh.

Kthejani kundrat **msitit** (**Miratoc, Preshevë**)

Kthejani kundrat msitit se po do me ik
I kish ardhë haberi i kish ik një cikë
Kthejani mësiti kundrat se po do me dal.
I kish ardhë haberi i kish dek një djalë.

Siç shihet edhe më këngë vërtetojmë se mesiti në një farë forme duhet të paguhet. Pra kjo e ka shtyrë edhe atë që të jetë më gjurmues në këtë aspekt. Në veçanti rreth pagesave të mesitit është, një veçori e lashtë e traditës sonë nga arsyeja se këtë gjë e hasim edhe nëpër hulumtime, po ashtu edhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit:

1. Shkuesi është një ndërmjetësues te dhëndri e te nusja(te djali e te vajza) që të mos luajnë fjalët as njëra as tjetra palë .

2. Shkues ka tagër mbi 50 groshë të shkuesit, për këpucë të preme prej kanuje.

3. Këpucët e shkuesit kanë vade me ditë që të merret nusja...

5. Këpucët e shkuesit i ban gjithherë shtëpia e dhëndrit... (KLD, Pika e 38)

Në përgjithësi hasim që mesiti ka qenë **person i paguar** dhe njëra ndër veçoritë është që ai nga dëshira e kryefamiljarit është paguar edhe **një lirë ari** më tepër. Kështu në përgjithësi mund ta marrim si një konkludim së shkuesi rreth çështjes së lidhjes së dy të rinjve i takojnë të hollat sa për një palë këpucë e jo më tepër.

Si në çdo vend edhe në rrethinën tonë, kohë pas kohe njiheshin mesitët dhe më pas ata i shihnin si mesitë profesionalë, që më pas ata edhe si mjet jetese e përdornin këtë profesion. Te ne më herët, por edhe në ditët e sotme hasim mesitë, që kanë bërë me qindra lidhje.

Fejesa është faza e parë e dasmës dhe zë fill atëherë kur merret fjala prej familjes së vajzës.

Pas një kohe familja e dhëndrit organizon një darkë për t'i bërë nder mesitit. Kështu ai e ka të drejtën e tij të marrë një sofër njerëz, gjegjësisht ky numër arrihet në 12-13 shokë, sepse ky është një dedikim enkas për mesitin dhe quhet sofra e mesitit. Gjatë kësaj nate mesiti e ka fjalën kryesore. Fjala e tij është ligj dhe shërbimi duhet të jetë në nivel të lartë.

Gati pas një muaji me ndërmjetësimin e mesitit, familja djalit duhet të bëjnë edhe vizitën e parë në familjen e vajzës, që të njihen për së afërmi dy familjet mes vete. Bile këtu njihen me njëri- tjetrin dhe “çojnë pare”. Kështu këta pos

peshqesheve për të gjithë anëtarët e familjes çojnë edhe gjëra tjera, për të bërë pajën (çejzin) dhe para të konsiderueshme për ceremonitë e vajzës. Familja e nuses përgatisin një drekë të mirë. Në këtë mënyrë njihen më mirë dy familjet të sapo miqësuar me njëra- tjetrën, ku me këtë akt tradicional merr fund puna e shkuesit .

Më herët, familja e djalit, vajzës i kanë sjellë lesh të dhenve ose tjerr për të bërë qilima, sixhade, pastaj “patiskë” për postava, çarçafë, bohçe të ndryshme, pëlhurë për këmisha etj. Kështu e tërë familja e vajzës me muaj kanë punuar për ta çejzuar të bijën e tyre. **Vajzës** i kanë pruar edhe “**patiskë**” për të **qëndisur**. Gjatë kësaj periudhe të gjitha vajzat e nuset tjera janë solidarizuar me vajzën e fejuar dhe i kanë ndihmuar për ta bërë pajën. Kështu secila ka marrë ndonjë punë dore. Disa vajza kanë bërë edhe pëlhurë në veg, për këmisha të pambukta. Siç po shihet, gjatë gjithë kohës sa rrinte vajza “ndër unazë”, e gjithë familja punonin ditë e natë. Punëdoret, që ka bërë vajza me kushërira, shoqe etj. janë të llojllojshme, si p.sh. qëndisje **Toledo**, **Ganavez**, **Me të mushme** etj. Ato shamitë e holla, **jashmakët**, **parllantat** etj. anëve i kanë zbukuruar edhe me **oja** të ndryshme. Për qëndisje kanë përdorë **jomakë** e **rokokoja** me ngjyra të ndryshme,(penj) që i kanë blerë nëpër dyqane, madje vajzat tona shpesh edhe i kanë ngjyrosur vetë penjtë, ndërsa tjerrin e kanë ngjyrosur te bojaxhiu.

Për **oja** kanë blerë **Çile** dhe penj të ndryshëm. Më herët nëpër familjet shqiptare të Preshevës është kultivuar edhe **krimbi** i **mëndafshit**. Domethënë, **gratë** e **vajzat** kanë rritur **krimba** të **mëndafshit**. Pastaj ata **penj** të **mëndafshit** i kanë shfrytëzuar për bërjen e **këmishave** të **mëndafshta** dhe **ojave** për **shamia**. Pëlhurën e **këmishave** të **pambukta** e kanë bërë në vek, pastaj i kanë qepur. Këmishat, te qafa dhe te mëngët e duarve, i kanë zbukuruar me **oja** dhe **rruaza** të ndryshme.

Është interesant të cekim, se në **Preshevë** për t’u dukur **ojat** më mirë, përreth i rrethonin edhe me qime të **bishti** të **kalit**. Shumicën e **ojave** i kanë bërë me gjilpëra shumë të vogla e ndonjëherë edhe me **Mikik**.

Për **qëndisje** kanë përdorur shumë **metoda**. Të gjitha janë bërë me **dorë**, pra me **gjilpërë**. Së pari, në “**patiskë**” janë **vizatu**ar e pastaj janë **qëndisur**. Si mjete ndihmëse kanë përdorur edhe **Kasnakun**. Shpesh **qëndisjet** i kanë bërë edhe me vrima, duke i prerë e nxjerrë nga një fije. Kësaj **qëndisjeje** i thoshin **Toledo**. Kur qëndisnin me **gjilpërë** dhe me **penj** me **ngjyra**, atëherë e quanin qëndisje **Ganavez**, **qëndisje me të mushme** etj.

Gratë tona shpesh për qëndisje e përdornin edhe **gjergjefin**. Qëndisja me **gjergjef** ishte paksa më e vështirë. Ishin të rralla gratë që qëndisnin në gjergjef.

Pra, gjatë gjithë kësaj kohe, sa ishte vajza “ndër unazë”, ajo vetëm çejzohej. Në shumë raste, **familja e djalit**, i kanë çuar nuses edhe **tjerr** të **pambuktë**

(**hallka**, të **pambukta**). Me këtë tjerr gratë, në **veg** , përgatitnin **pëlhurë** për **këmisha** të **pambukta**. Këto këmisha qepeshin për trupi dhe shumë u rrinin mirë nuseve. Atëherë, kjo pëlhurë, **matej** me **kut** (njësi e gjatësisë rreth 70cm). Pra, zakonisht dëgjohej nga gratë duke thënë: “ **I bonëm 120 kuti pëlhurë**”. Është interesant se pëlhura ka qenë e gjerë rreth 50 cm. **Pëlhura** ka qenë e **bardhë**, por anash në brendi prej 2-3 cm, ka qenë si shirit, në të dy anët, “**pembe**”.

Në **pajë**, **nusja** ka pasur edhe **këmisha** “të **rrudhta**” ose të **mëndafshta**. Këto i blinin në **Shkup**, **Prizren**, **Gjakovë** etj. Edhe këto **shiteshin** me **kute**. Materialin e blerë e pritnin dhe e qepnin në shtëpi, madje në **grykë** dhe te **mangat** i zbukuronin me **oja** të ndryshme. Ka raste që edhe sot kemi aty-këtu këmisha të tilla, apo të ngjashme.

Po e cekim edhe këtë se **nusja** në **pajë** kishte edhe **skuta** “**mshallakë**” të **leshtë**. Zakonisht ata ishin të **kuqe** ose të **zeza**. Të **kuqtë** ishin për **nuse** e të **zitë** për **plaka**. Deri vonë. Çdo grua e moçme, patjetër çdo ditë, në punë e pas pune, ka **veshur** mbi petkat tjera edhe **skuta**. Ato kanë pasur “**mshallakë**” për punë dhe për të dalë diku.

Më vonë , dy familjet fillojnë të bëhen gati për **dasmë**. Por gjithsesi në **familjen e djalit** gjendja ndryshon nga ajo e **vajzës**, sepse në atë familje **këngët e dasmës** nuk pushojnë. **Motrat** tërë ditën, vetëm **këndojnë këngë të lumtura**, ku **vlerësohet shumë djali**, vajza dhe familja e tyre, ndërsa kemi edhe mbizotërimin e shfaqjes së **refreneve cinike** ku **përqeshet familja e nuses**.

Lum oborri (Preshevë)

Lum oborrin, lum oborrin,

kush e shkel me komë,

lum nona, kush e thirr oj nonë,

Oj nona jeme e omël, e omël

Ku ta viri kusijën me tomël?

Vire bijo, vire n’derë t’fllanikit,

Aty njihet çika e shpijanikit...

Kjo këngë është kënduar para 60 vjetësh në fshatin **Norçë** nga **Havçe Ibishi**, lindur më 1942. Kështu pra, prej fejëse në shtëpinë e djalit kënga s’pushon fare. Pra është koha që familjet të merren vesh për afërsisht për kohën se kur do ta bëjnë dasmën. Në shtëpinë e vajzës vazhdon puna. Gjatë kësaj periudhe vajza

vazhdimisht çejëzohet, duke e bërë gati pajën e saj. Disa familje të pasura me anë të vegut bëjnë qilimat, janet e sixhadetë. Pasi i kishin bërë pëlkurat, i qepnin këmisha të pambukta. Vazhdimisht gjatë punës këndohej me zë të ulët, por kishte raste kur këngët shoqëroheshin edhe me lot, sepse mungonte ndonjë pjesëtar i familjes, që nuk ishte për ta ndonjë gjë e lehtë.

OJ LULIJE (Corroticë, Preshevë)

Oj lulije me ni letër unë fjalë t'kam çue,
O çfarë fustani don me t'prue?
– Unë kam dëshirë fustanin me flutra,
E të bohem nuse ma e bukra...
– O me ni letër unë fjalë t'kam çue,
O çfarë dimija don me t'i prue?
– Unë kam dëshirë dimijat me lula,
O që të bohem nuse ma e mira...

Para se ta caktonin ditën e dasmës është një rit tjetër që njihet me emrin Marrja e masës. Familja e burrit shkon në shtëpinë e vajzës për ta marrë masën. Më herët për masë ia jepnin një pe të kuq me përmasat e trupit të vajzës, belin dhe gjatësinë. Më vonë në vend të perit ia japin një fustan, ku nëpërmjet atij fustani do t'i qepnin edhe petkat tjera të nusërisë. Dikur i vjen edhe caktimi i ditës së dasmës, ku te ne njihet me emrin ku edhe sot e po i njëjti term përdoret “**Dahet vadj**”. Për këtë ditë është një gjë e veçantë, sepse për herë të parë pas gjithë atyre punëve që bëhen merret edhe mendimi i vajzës. Ku edhe në popull thuhet se vadën e dasmës e ndan çika. Arsyeja e gjithë kësaj çështjeje është se vjen nga ndikimi biologjik, ku këtu duhet të llogaritet në ciklin menstrual të vajzës. Gjithashtu shtëpia e djalit kërkon nga familja e vajzës që e kanë ata dëshirë që të porosisin diç për vajzën apo të shtojnë diç në lidhje me peshqeshet që duhet t'i bëjnë familja e burrit. Shpesh kishte ndodhur, ku familja e vajzës kishte pasur kërkesa të shumta për të blerë ndonjë fustan më të mirë, madje edhe për ndonjë anëtar të familjes, që në peshqeshet e para (kur kanë pru pare) e kanë harruar ose ndonjë rast tjetër. Ka pasur edhe mjaft raste ku babai i vajzës ka kërkuar që vajzës t'ia rregullojnë edhe një dhëmb të arit apo së paku “t'i sardiset ni dhom...”

Gjithashtu familjet në fjalë merren vesh edhe për disa gjëra rreth asaj se me sa qerre duhet të vijnë për ta marrë nusen, sa seksone duhet të jenë, a duhet të marrin me vete muzikë apo jo, pra të gjitha këto vendos familja e vajzës. Duhet të ceket se për seksonet (pajën) varet se sa qilima janë nëse nusja i ka dy qilima, atëherë duhen dy seksone, por në qoftë se kemi vetëm një qilim atëherë duhet

vetëm një seksone. Seksonet janë kuajt e ngarkuar me pajën e nuses, që ecin para qerreve.

Dy ditë para se të fillojë dasma familja e burrit me 3-4 burra i çojnë petkat në shtëpinë e nuses. Ata pos rrobave të nuses me shumë fustane, dimi, ari e veshmbathje tjera sjellin edhe peshqeshe për anëtarët e familjes e më gjerë. Dy lloje veshje të nuseve. Shpesh gjatë kësaj ceremonie bëhet edhe riti i niqahit (nikah), ku këtë rit ceremonial e kryen hoxha (imami). Kështu hoxha i fton nga një përfaqësues për çdo familje me nga dy dëshmitarë. Preferohet që njëri nga dëshmitarët të jetë sa më i ri. Kurora (nikah) për afërsisht bëhet se hoxha pyet përfaqësuesin e vajzës se sa kërkon për niqah. Zakonisht më parë vlerësohej me drithë apo lira ari, ndërsa tash ka pësuar ndryshim, ku bëhet me anë të parave. Kështu përfaqësuesit thotë se po kërkoj 3000 marka (sot bëhet me euro). Përfaqësuesi i djalit ofron 1000 e fjala e tretë, ku thuhet që prehet është 2000 marka. Kështu sipas “Sheriatit” aty duhen të jenë të pranishëm edhe vajza edhe djali, por kjo nuk ndodh, pastaj po ashtu sipas ligjit fetar është se ato të holla në këtë rast 2000 marka duhet t’i jepen menjëherë nuses, por edhe ky rit ceremonial ka pësuar ndryshime dhe asnjë informator nuk na e vërtetoi se me të vërtetë ju kanë dhënë nuses paratë e tilla. Mirëpo, në qoftë se ka ardhur, më vonë deri te ndarja, atëherë nuses i është dhënë edhe **Niqahi** (paratë) me përjashtim që nusja nuk ka qenë e moralshme. Këtë e pohuan të gjithë informatorët.


Këto të holla kryesisht janë të dedikuara, që në nëse burri më vonë e largon nusen apo gruan e tij, gjegjësisht siç thuhet e lëshon gruan, atëherë ajo do t’i shfrytëzojë ato të hollat që i duhen për domosdoshmërinë jetësore. Ky rit sipas disa hoxhallarëve deri vonë nuk është shënuar askund, ndërsa tash e tutje hoxhallarët pohojnë se është një shënim i veçantë në fletore, që ruhet nga imamët që bëjnë niqah. Duhet përmendur se në shtëpinë e vajzës që nga fejesa e deri sa fillon dasma nuk këndohen kurrfarë këngë dasmash.

Ndarja e vadës, gjegjësisht caktimi i datës së dasmës hap ritin për t’i kryer disa punë. Kështu njerëzit e shtëpisë së djalit, tash mund t’i thërrasin miqtë, pastaj merren vesh edhe me muzikën, dahirexhiket (defatoret) etj. Me ndarjen e vadës gëzimi hareja, këngët etj. nuk kanë të ndalur, madje edhe me një ritëm më të shtuar. Pra njoftohen dhe ftohen për në dasmë miq e dashamirë të familjes, bija e dajallarë me qëllim që mos të caktohet edhe ndonjë dasmë tjetër. Thuhet se edhe dasmat kishin orarin e tyre të caktuar dhe bëheshin në pranverë (Shëngjergj) dhe në vjeshtë. Pra nuk bën që brenda një kohe të caktohen dy dasma, por të caktohet vetëm një nga arsyeja që të marrin pjesë të gjithë të ftuarit. Bëhen përgatitjet e duhura në dy vija, në njërin anë bëhen përgatitjet për dasmën e burrave, ndërsa në anën tjetër përgatitjen për dasmën e grave. Pos familjes në përgatitje marrin pjesë

edhe të afërmit të tjerë. I zoti i shtëpisë i blen të gjitha gjërat e duhura, sheqer, llokume, cigare, çaj, pije alkoolike dhe joalkoolike e shumë gjëra të tjera. Punën më të madhe e bëjnë gratë. Ato në mënyrë të organizuar hollojnë bakllava, pite por ato bëjnë edhe planin për këtë rit gëzimi me qëllim që të mos koritet familja e Filan Fistekut.

Bakllavaja

Burrat e lagjes mblidhen dhe e bëjnë planin e duhur. Ata e dinë se në dasmë më shumë koriten fqinjët se sa i zoti i shtëpisë. I zoti i shtëpisë është i detyruar të blejë ç'të duhet për dasmë, e për mikpritjen përgjigjen fqinjët. Pra në këtë rast fqinjë quhen kushërinjtë, të afërmit e asaj familjeje. Në këtë mbledhi caktohen gati të gjitha detyrat me përpikëri të madhe. Së pari i zoti i shtëpisë tregon, bën raportimin apo jep numrin se sa miq janë të ftuar. Pastaj caktohen edhe konakët, gjegjësisht dhomat se ku duhet të vendosen miqtë. Miqtë vendosen në shtëpia tjera dmth, jashtë shtëpisë së dhëndrit. Kështu me këtë mbrëmje caktohen miqtë nëpër dhoma, pra duke i caktuar nga 13 - 16 njerëz në një odë, sepse zakonisht gati të gjitha dhomat janë me madhësi mesatare 4 me 4 metra. Për çdo dhomë caktohen nga dy djem si shërbyes, siç thuhet te ne hyzmetçi, e këta marrin përgjegjësinë për dhomën dhe miqtë e tyre. Ata i bëjnë gati të gjitha mjetet shërbyese. Para dyerve caktohet dikush që i drejton në konakun e duhur. Para derës së shtëpisë janë të caktuar të rinjtë, që kujdesen për këpucët e mysafirëve.



Për atë natë caktohet edhe çajxhinjtë, që ia dinë rendin çajit, sepse në dasmë i kushtohet shumë rëndësi çajit, pra duhet të jetë çaji i përgatitur mirë, sepse ndodh që ndonjë nga miqtë e kthen çajin, nëse nuk është i cilësisë së mirë. Gjithashtu në mënyrë globale bëhen edhe plani orientues rreth numrit të grave dhe burrave që shkojnë për të marrë nusen. Caktohen edhe fëmijët që do të jenë me kuajt e seksoneve dhe më herët caktohet edhe një fëmijë mashkull, i cili duhet të hedhë

leblebitë. Ai do të jetë në qerre me gratë.

Pak ditë para fillimit të dasmës, vijnë bija e mbesat. Bijat me vete sjellin edhe ëmbëlsira të ndryshme. Kështu edhe pa filluar zyrtarisht dasma, gazmendi fillon me motra, mbesa e kushërira. Ato edhe ndihmojnë me shpirt. Djemtë e familjes së djalit shkojnë për t'i mbledhur (marrë) bijat:

Po bje shivi vija vija

(Maxhere, Preshevë)

Po bje shivi vija- vija

po shkon Azemi me mledhë bija

Po bje shivi pika- pika

Po shkon Azemime mledhë çika...

Zakonisht bijat e mbesat i kanë marrë me qerre. Ato janë shumë të lumtura, sepse po vijnë në gjini për gëzim. Këtë ditë e kanë ëndërruar me muaj. Është interesant të përmendet, se pa filluar dasma, njerëzit e lagjes mbledhen dhe shkojnë në mal për të siguruar drutë për dasmë. Ata shkojnë në mënyrë të organizuar. Kur të vijnë nga mali kanë një darkë deri diku të mirë. Këtu shihet edhe bamirësia dhe solidariteti i fqinjëve, pra kur është puna e dasmave dhe vdekjeve të gjithë bëhen së bashku. Për këtë arsye vlen e thënia popullore “Deka edhe darsmja s’bohen vetë...” Në trevën pothuajse të gjitha dasmat bëheshin më së shumti në vjeshtë, por edhe në pranverë. Kjo kohë te ne njihet si një ndër stinët më të begatshme dhe idealja për dasmë. E bash për këtë arsye, dikur shpesh e dëgjonim shprehjen “Tash osht koha e darsmave...”. Dihet se te ne nusja kryesisht e ka ditën e marrjes të caktuar të enjten ose të dielën, mirëpo në raste kur vajza ka qenë e martuar (vejushat) është dashur të jetë një ditë tjetër. Te ne ka qenë dita e martë ose e shtunë.

K r e u VI

D A S M A

Akti përfundimtar i martesës është dasma (në shtëpinë e dhëndrit) dhe

kanaxheçi (në shtëpinë e vajzës). Në të dy rastet këtë gëzim e organizojnë burrat, sipas traditës, por edhe femra është pjesëmarrëse aktive, sidomos në punët që u përkasin grave. Dasmat tradicionale zgjatnin tri ditë e net dhe organizoheshin për të marrë nusen ditën e hënë ose të enjte. Të marteve martoheshin të vejat, me më së shumti 7 krushq. Në kohën tonë nuk veprohet kështu. Të gjitha ditët e javës janë dhe ditë dasmash. Dasmat tradicionale zgjatnin tri ditë e net dhe organizoheshin për të marrë nusen ditën e hënë ose të enjte. Të marteve martoheshin të vejat, me më së shumti 7 krushq. Në kohën tonë nuk veprohet kështu. Të gjitha ditët e javës janë dhe ditë dasmash. Dasmat e djemve zakonisht zgjasnin 4 ditë , pra që nga e hëna e deri të enjten ose prej të enjtes deri të hënën. Dita e parë e dasmës quhet **“Nata e kallamoçave”**. Për këtë ditë njerëzit e shtëpisë ziejnë kallamoça, tramakë misri, apo dimrit, kokrra misri. Për këtë natë thirren vetëm të afërmit, komshinjtë, bijat, mbesat, nipat. Kjo natë është shumë e thjeshtë dhe pasi që hanë kallamoçat (tramakë të zier) bisedojnë edhe për dasmën, gjegjësisht për ditën kur do të vijnë miqtë e ftuar. Edhe këtë natë, gratë dhe burrat rrinë ndaras. Të ftuarit nuk rrinë shumë, sepse të nesërmen ata duhet të jenë të pushueshëm.

Ditën e premte që njihet edhe si dita e grave, dasma zhvillohet më tepër në shtëpi, pra dasma për gra. Ku me këtë ditë s'pushojnë fare dajret me këngë e valle. Në këtë trevë, zakonisht i kanë zënë më herët defatoret (dahirexhiket), që kryesisht kanë qenë të nacionalitetit rom. Nëpër dasma kanë shkuar nga dy defatore. Më vonë me dajre vinte edhe një tupan (tarabuke) Është dashur të caktohen herët, sepse ziheshin nëpër dasma tjera të rrethit. Po ashtu si pengesë ka qenë edhe numri i kufizuar i tyre. Këtu njiheshin defatoret rome si edhe informatorët tregonin se quheshin: Razija, Gjylizarja, Sania, Mexhidia, Nifa, Fetia etj. Defatoret nuk ishin shumë profesionale. Kryesisht dinin t'i përcillnin disa valle krahinore. Ato këndonin edhe këngë, por më një gjuhë shumë të bastarduar dhe vërehej shumë shqiptimi i keq i fjalëve. Kështu muzika e tyre ndahej në dy pjesë, në “kajde” kur defatoret me përcjelljen e defit, këndonin këngë të ndryshme dhe në valle (hora) kur gratë luanin (kërcenin).



Pra ditën e premtë, pos grave të ftuara, vijnë edhe gra të tjera. Nusët vishen me rrobat më të zgjedhura. Dikur më së shumti me dimi e më vonë kishte edhe fustane të llojllojshme. Të gjitha gratë hyjnë nëpër dhoma dhe ulen, ndërsa nusët rrinë kah dera në këmbë ose të ulura nëpër karrige të improvizuara.

Më së shumti luhen valle nga nusët dhe bijat. Pra, ato edhe e bëjnë atmosferën. Valltaret gjatë valleve nuk janë të lira, por sillen si të ngrira dhe shumë delikatese. Vallen e hedhin gratë me radhë. Këtu vallet luhen në mënyrë grupore. Pra njëra e udhëheq, ndërsa të tjerat të kapura dorë më dorë e përcjellin në formë gjysmë rrethi edhe atë vetëm në të djathtë. Ashtu të kapura dorë për dore duart i kanë të ngritura deri në kraharor. Rrallë ndodh që i lëshojnë duart dhe luajnë, siç thuhet te ne “Karshi-karshi...” Ajo nuse që e udhëheq vallen ndryshe quhet edhe horatore, sepse e ngrehin horën (pra valles në rrethinën e Preshevës i thonë horë), prandaj shpesh te ne thuhet na “pe lujmë një horë, apo e ngremi një horë, tash merre ti horën...”. Madje, këtu dëgjohet edhe shprehja : “A pe kcejmë një horë, ose tash kemi me key një horë etj”.

Nusët duke luajtur valle në një dasmë në Preshevë

Gjatë luajtjes së valleve të afërmit e “horatores” rrahin shuplaka, pra me anë të duarve e përcjellin ritmin me duartrokitje, bile defatoreve u japin edhe para. Është edhe një gjë që gjatë ditës nusët e reja shpesh i ndërrojnë gardërobën, pra për një natë mund t’i ndërrojnë tre deri 4 fustane të posaçme për nusëri. Është si një lloj vesi i natyrshëm që gjatë hedhjes së valleve, të afërmit e nuses që hedh vallen, defatoreve u japin të holla. Pas valleve, defaret pushojnë, nusët ulen nëpër vendet e veta dhe tash vjen koha, kur vajzat ia marrin këngës. Ato kryesisht këndojnë këngë dasmash nga më të ndryshmet, madje edhe improvizojnë. Një pjesë e këngëve u kushtohet nuseve. Vajzat këndojnë këngë, ku i drejtohen nuseve

me radhë. Nëpërmjet këngëve ato i porosisin nuset të bëjnë “temena”.

KCENI MORI KCENI
(Norcë, Preshevë)

Kceni mori kceni se na shkoj kjo natë,
Të lumtë na të lumtë po marim kunatë,

Knoni mori knoni se na shkoj kjo ditë,

Ani mori ani çeto kena pritë!

Hajde knojna, oj motrat e mija,

Çelni dyer e xhama, le t’na ndinë kojshia,

Le t’na ndinë kojshia ani edhe mahlla,

S e po martohet Shaban aga...

ATJE POSHTË
(Geraj, Preshevë)

Çatje poshtë moj ndër katund,
nana e Bajramit po ban lum,
lum e lum oj nana po ban,
djalë mat mirin nana marton.

Çatje poshtë moj ndër katund,
baba i Bajramit po bon lum,
lum e lum oj nanë baba po bon,
djalë mat mirin baba marton.

Nëpërmjet të këtyre vargjeve, na e paraqesin se kjo shtëpi, s’heq për ujë, pasi pos që e kanë lumin pranë shtëpisë, e kanë edhe pusin para derës. Gjithashtu vërejmë se shtëpinë e kanë afër xhamisë dhe mejtepit. Këtu shohim se kënga është kënduar herët, domethënë. Ende para hapjes së shkollave shqipe, pra kur funksiononin mejtepet. Pastaj, në këngë thuhet se kush të na ketë inati le të pëlcasë.

Sepse nusja jonë është e bukur si yll drite.

JENA GZU
(Bushtran, Preshevë)

Jena gzu e jena gzu,
jena ba me fluturu.
Fluturojmë e shkojmë në hava,
na Lulijën vetë e kena pa.
Flutur flutur shkon n'hava,
si Lulija jalla s'ka,
as s'ka vajzë as s'ka çikë,
si Lulija jalla bukuri.

Në të tria këto këngë, të kënduara në tre fshatra të Preshevës, shohim se këtu shprehet gëzimi e hareja. Gjithashtu nuk kursehen fjalët e mira për nusen, ku përveç prindërve gëzohen edhe anëtarë tjerë të familjes, madje i gjithë katundi. Ata krenohen se nusen, bile vetë e kanë parë.

Shpesh ndodh që disa gra, edhe pse të shtyra në moshë, janë valltare të mira, kështu që ato fillojnë të vallëzojnë, kuptohet pas kërkesave të të pranishmeve. Është interesant, se kur luajnë ato valle edhe defatoret duhet të jenë më të vëmendshme dhe nuk guxojnë fare të gabojnë. Ato vallet e tyre i luajnë me një përkushtim të madh. Çdo hap i valles është një lëvizje me takt, pra vallja që luhet nga to, luhet me gjithë shpirt dhe me një seriozitet të madh. Shpesh prej valleve të grave kalojnë edhe në valle më të renda në ato të burrave. Në kërcim ato janë më të lira, pra jo të shtangura. Pas tyre s'ka më valle, sepse vallet e tyre janë të shënjura dhe lezeti i valleve merr fund.

Nuk e cekëm më parë, por zakonisht dasma zhvillohet pas dreke. Kështu që para drake gratë i kryejnë punët e tyre të shtëpive. Edhe njerëzit e shtëpisë së dasmës gjatë kësaj kohe bëjnë drekën edhe pasi të drekojnë bijat, mbesat etj. vishen dhe bëhen gati për t'i pritur gratë e mëhallës (lagjes) së fshatit e më gjerë. Këtu vijnë edhe gratë e paftuara, pra vijnë gratë nga dëshira e tyre. E njëjta gjë përsëritet edhe ditën e premtë, bile kjo ditë thuhet edhe “Dita e grave”. Më së miri këtë e vërejmë edhe në këngën “Kena darsëm”, që na e këndoi, bija e **Norçës Mevlude Saqipi (Mifteri)**

KENA DARSËM

(Norçë, Preshevë)

Kena darsëm e kena gazmend,
kush po ndin o te na po vjen.
Po na vinë thirr e pa thirrë,
ata i kemi miç e dashamirë.

Vlen të thuhet se drekë e darkë shtrohet vetëm për bijat, mbesat dhe njerëzit e shtëpisë, ndërsa të premtën në darkë thirren edhe gra të tjera të farefisit dhe mikesha nga rrethi apo edhe më gjerë. Për përgatitjen e ushqimit caktohen gratë më herët, gjellëtore e magjetore të farefisit apo shpesh i zënë edhe me pagë. Kështu janë gra që shquhen për përgatitje për ushqimin e dasmës. Atë natë ka gra shumë dhe bëhet edhe tollovi. E për këtë arsye gratë e shtëpisë dhe të farefisit përpiqen me mish e me shpirt që të mos koriten. Ato vazhdimisht janë në shërbim të të ftuarave. Edhe për darkën e grave planet janë bërë më parë, madje janë caktuar edhe nuset që do të shërbenin nëpër dhoma. Derisa nuset janë të angazhuara brenda, të gjitha punët tjera i bëjnë vajzat beqare. Të gjitha gjërat, ato i sjellin deri te nuset e pastaj... Gjatë ardhjes së grave caktohen tri-katër vajza që ia marrin grave mantelet, gjërat tjera dhe i ruajnë deri sa ato rrinë në aheng. E njëjta gjë veprohej edhe me këpucët...

Është interesante se nëpër familjet më të njohura të qytetit, kanë angazhuar edhe ndonjë grua për t'i ruajtur këpucët e grave, sepse ndodhte që këpucët humbnin apo edhe ngatërroheshin, kështu që gruaja që paguhet mbante përgjegjësinë për këtë punë.

Në kohën e darkës zakonisht përgatitjet ishin pothuajse të njëjta, ku aty servohej çorbë, fasule, jani (gjellë me perime e me mish) pite (lloj byreku) dhe ëmbëlsirat ishin ato që të fundit, si p.sh. tatli dhe bakllava. Kishte raste që përgatitej edhe tomëloriz (sytliaç). Për të gjitha këto kujdeseshin gjellëtoret dhe magjetoret, që ishin të angazhuara enkas për këto gjëra, pra këto kishin barrën kryesore, sepse këtyre u bie mbi supe lavdi ose turpi.

Pas darkës vazhdonte gëzimi dhe kënga. Vinin edhe gra të tjera. Përsëri ahengu rifillon me defatoret që e kishin fjalën kryesore. Pas (kojkave) këngëve vazhdonin edhe me valle. Zakonisht kërcejnë valle nuset e reja. Ato nuk e kanë atë liri që të çohen vetë të kërcejnë, por roli i vjehrrës edhe këtu, është i madh. Pra, ajo jep urdhër që të kërcejnë, po ndodh që ta urdhërojë edhe ndonjë nga njerëzit e shtëpisë së tyre. Ato vishen me petkat më të mira me fustanet më moderne. Disa vishen me dimi, sepse i kanë blerë bash për gëzime të tilla. Vallet fillojnë me një ritëm shumë të ngadaltë e që kështu vazhdojnë deri në fund. Edhe pasdarke këto valle përcillen në mënyrë ritmike me duartrokitje, prej vajzave e grave që përcjellin

valltare.

Pas valleve nuset ndërrohen me veshje të tjera. Tash fillojnë vajzat të këndojnë këngë dasmash. Ato këngët e tyre shpesh i improvizojnë, pra në një kohë janë edhe vetë krijuese të menjëhershme. Më tepër i lavdërojnë nuset . Nëpërmjet këngëve ato i ftojnë nuset që të bëjnë temena (përsëritje) të ndryshme. Për ndonjë nuse që nuk është shumë e shkathtë nëpërmes këngës i thonë që ta bëjë "temenanë" qysh ta dijë.

Oj nusja e Ali agës he dalldyshë

Bonaj temenanë qysh ta dish.

Merrja vjehrrës të dy duart (Rahovicë, Preshevë)

Oj Halise, he gugutkë,
merrja vjehrrës të dy durt,
të dy durt me ni krah,
t'boje vjehrra: "Mashallah"

Me jardam ti ec moj motër,
gjithë ti ec me jardam,
Qit ni hap e temena bon.

Kështu, nuses që dedikohej kënga, me hapa të vegjël e ngadalë i afrohet vjehrrës dhe në shenjë respekti e me delikatesë të madhe ia merr duart dhe me shumë kërrname ngadalë largohet prej saj. Duke u larguar te mbrapa në çdo hap bën temena...

Për këtë mirësjellje të nuses vajzat këngëtare e lavdërojnë duke kënduar:

Oh sa mirë e bone,
Oh sa mirë e dite,
Ani vjehrrën tonde,
Fare s'e korite...

Këto vargje e bëjnë si nusen, ashtu edhe vjehrrën të ndihen krenare. Për këtë këngë na foli dhe na e këndoi, profesoresha e gjuhës shqipe Hidajete Haliti nga Rahovica (57 vjeçe).

Në kanagjegj vijnë shumë gra e nuse. Nuset të veshura secila më mirë se tjetra rrinë në këmbë ose të ulura te dera, ndërsa vjehrrat dhe plakat janë ulur në krye të dhomës. Vajzat me anë të këngës, i detyrojnë nuset të bëjnë disa ceremoni. Në strofën e parë, ato, njërin prej nuseve e quajnë gugutkë (Te ne gugutkë i themi kumrisë) dhe porosisin t'ia marrë vjehrrës të dy duart, e vjehrra të kënaqet. Nusja të ecë me një ecje nusërie dhe pas çdo hapi të bëjë temena.

Kështu kjo nuse e bën ndonjë temena të lehtë, që sigurisht e ka ushtruar edhe në shtëpi. "Temenatë" bëhen në mënyrë shumë delikate dhe me një përsosmëri të madhe. Zakonisht temenatë bëhen për hatër të vjehrrës, kunatave, vjehrrit etj. Nganjëherë temenatë janë shumë të komplikuar. Këtë mund ta marrim edhe si një garë të nuseve se cila po e bën temenanë më mirë.

Vajzat këndojnë e ndodh që me këngë i porosisin nuset që të pranishmeve t'ia marrin dorën, varësisht prej këngëve, mund t'ia marrin një dorë apo të dy duart. Gjatë kësaj ceremonie gratë e tjera vetëm i përcjellin me vëmendje të madhe se si po i kryejnë detyrat nuset e reja.

Zakonisht kështu vazhdon deri kah ora 24:00. Pastaj të gjitha largohen dhe shkojnë nëpër shtëpitë e ndërsa të tjerat mbesin në shtëpinë e dasmës për të fjetur.

Ditën e shtunë, paradite gati se pushojnë të gjithë.

Gjatë kësaj dite në mbrëmje burrat në oborrin e dhëndrit fillojnë t'i bëjnë gati qerret, që shkojnë për të marrë nusen. Disa djem qysh herët në mëngjes, kanë shkuar në mal për të marrë disa copë drunj të hollë e të gjatë për ta rregulluar "koçinë" e qerreve, që u thoshin "thupra të kerrit"

Pas dite, në oborr është atmosferë dasme. Një ose dy qerre janë në oborr dhe i përgatisin për nuse. Pra, që më herët duhet të dihet se me sa qerre do të shkojnë të marrin nusen me një ose me dy. Kjo më së shumti varet se si janë marrë vesh me njerëzit e nuses. Pra ata e caktojnë se si do të vijnë krushqit me një qerre, me dy ose vetëm me kalë.

Burrat i rregullojnë qerret ndërsa vajzat, bijat, nipat e mbesat këndojnë e luajnë valle afër qerreve. Në formë gjysmë rrethi me thupra bëhet "koçia" në qerre. Pastaj me hasra e mbi to vihen qilima të kuq, pra kjo është karakteristikë kryesore, sepse qerret e nuseve duhet të jenë të mbuluara me qilima të kuq. Para dhe mbas vendosen çarçafë të bardhë, ku disa informatorë e shpjegojnë nga arsyeja që mos të shihen gratë që janë brenda, në qerre. Burrat vendosin se cila do të jetë qerrja e parë e cila qerrja e dytë. Zakonisht qerrja e parë ka një pamje më të theksuar nga ana e zbukurimeve, sepse ajo qerre është qerrja e nuses, pra aty do të hipë nusja. Së paku një ditë më herët caktohen edhe gratë e vajzat se kush do të hipë në qerre. Ndodh që gratë mund edhe të hidhërohen pse s'i kanë caktuar për në qerren e parë. Po ashtu caktohen edhe burrat. Thuhet se shumë më herët për ta marrë nusen kanë shkuar më shumë burra e më pak gra, e më vonë kjo dukuri filloi të ndryshojë, ku më shumë shkonin gra se sa burra. Madje në qerret që janë me qe ose me buaj caktohen edhe djemtë se kush do t'i ngrejë qetë ose buajt. Por nëse shkohet me kuaj aty dihet, se pos të zotit të kuajve që do t'i drejtojë ata, shkon edhe një burrë tjetër, i cili ulet afër grahësit të kuajve. Po atë natë vendoset se cilët djem 13-14 vjeç i

mbajnë për dore kuajt e seksoneve, pra kuajt të ngarkuara me pajën e nuses. Të gjitha këto plane bëhen para mbrëmjes.

Nëse për dasmë kanë ftuar miq dhe kanë muzikë, atëherë secili anëtar i farefisit e merr, punën e vet, për të cilën është caktuar më parë. Të gjitha gjërat dhe parapërgatitjet janë bërë edhe më herët e tash duhet vetëm të fillohet puna. Ata përgjigjen për konakun e tyre. Ata i marrin cigaret, shkrepsat, legenin, ibrikun me gotat e ujit, kënatat me ujë etj. Gjithashtu në vendin e vet është edhe çajxhiu me ndonjë ndihmës.

Muzikantët duhet të jenë tri orë përpara mbrëmjes dhe të jenë të përgatitur me veglat e tyre. Aty luhet e kërcëhet.

Para mbrëmjes të gjithë bëhen gati për t'i pritur dasmorët (miqtë). Aty është edhe muzika, ku për çdo mik që vjen ata bëjnë muzikë e miqtë shpesh e nderojnë muzikën edhe me para.

Njeri nga të afërmit, që është i caktuar më parë i orienton miqtë se në cilin konak duhet të shkojnë, sepse ndarja është bërë më herët, pra ditëve tjera. Secili shërbyes (hyzmeqar) i drejton në konakun e (dhomën) e caktuar prej më herët. Së pari i shërbejnë me cigare dhe bile edhe ia ndezin pastaj i ofrojnë llokume e pije joalkoolike ose ujë, gostitin me çaj nga dy e më tepër. Është interesant se te ne miqtë, për dasma, nuk shërbehen me kafe. Kur një mik e merr në dorë cigaren shërbyesi është i detyruar dhe menjëherë shkon tek ai dhe ia ndez cigaren. Kështu vazhdon tërë nata.

Duhet ditur se kur të vijnë miqtë një person, apo më tepër janë caktuar që të kujdesen edhe për këpucët e tyre. Ata i marrin këpucët e miqve dhe i strehojnë në vendet adekuate të caktuar. Atë ditë ata e kanë për detyrë të jenë përgjegjës për këpucët. Ka raste, kur kujdestarë çdokujt ia shënojnë nga një letër emrat e tyre dhe ia lënë te këpucët. Kështu që kur të shkojnë më lehtë ia gjejnë. Më herët kishim ardhjen e miqve me kafshë kryesisht me kuaj, kështu që në atë mënyrë është dashur të caktohen njerëzit për përkujdesjen e kuajve. Caktohej kryesisht personi që ia dinte rendin të bëjë këtë punë. Pra, secili duhet të kryejë punën e vet. Të gjitha këto punë kryheshin në mënyrë shumë të sinkronizuar. Po e cekim se nëpër dasma dasmorët heqin dorë prej lutjeve fetare. Kështu të gjithë informatorët deklarojnë se kurrë nuk i kemi parë dasmorët duke u falur (u lutur).

Kur mendohet se kanë ardhur njerëzit e ftuar, atëherë jepet urdhri që të fillojnë me darkën. Të rinjtë fillojnë t'i sjellin gjellët etj., ndërsa shërbyesit i ofrojnë miqve t'i lajnë duart. Te secili ofrohet legeni, uji, sapuni e peshqiri. Pas larjes së duarve shtrohet sofrabezi e sofa në çdo dhomë. Zakonisht për dasma përgatiten këto gjella dhe që vihen me radhë, si: çorba, fasulja, jania, mish me oriz, pite, bakllava ose ndonjë ëmbëlsirë tjetër, në fund edhe tomëloriz (këtu i thuhet sytliaçit). Njëri prej familjarëve të dasmës i thotë urdhëroni(bujrum) dhe ju bëftë

mirë ata fillojnë të hanë kështu duke i ndërruar gjellët me rend. Hyzmetçinjtë rrinë me gotë dhe ibrik në dorë dhe kush lyp ujë, ia ofron menjëherë. Pasi ta hanë edhe ëmbëlsirën shpesh bëjnë edhe duanë e bukës (aminin).

Pas ngrënies së darkës vjen edhe çuarja e sofrës, ku fshihen trohat dhe menjëherë vijnë hyzmetçinjtë me legen, sapun, peshqir dhe ujë. I lajnë duart më shpejt e mirë se “teraqitë” e duhanit nuk presin shumë. Pra, menjëherë bëhet ndezja e cigareve. Pas tyre tani i vjen radha të hanë darkë edhe njerëzit tjerë të familjes , po ashtu edhe ata që bënë hyzmet do të hanë në atë kohë. Tash është koha e muzikës. Në çdo konak (dhomë) muzika shkon me rend, nuk bën asnjë dhome t’i bëhet me hile. Deri sa në dhomë është muzika, në dhomat tjera vazhdon biseda me shaka të ndryshme.

Zakonisht në fillim muzika bën "kajde", pra këndojnë . Kemi thënë se muzikantët janë romë, që shumë vështirë i shqiptojnë fjalët në gjuhën shqipe, por është për keqardhje, se si ata kanë kënduar prapë e mbarë. Nganjëherë dasmorët porosisin edhe ndonjë këngë. Pas një pushimi të shkurtër, fillojnë me vallet. Zakonisht për të vallëzuar çohen 3-4 veta. Njeri udhëheq vallen dhe quhet horator, ndërsa të tjerët i shkojnë pas duke e përcjellë horatorin të kapur dorë për dorë, për shoke ose edhe krah për krah. Vallen e udhëheqin thuajse me radhë. Nëse ndokush dallohet si valltar i mirë, atëherë i jepet përparësi. Në fillim secila valle fillon e qetë , me një ritëm të ngadalësuar, pastaj vjen ritmi duke u shpejtuar shumë e më shumë. Muzika e përcjell hedhësin e valles, por edhe ai i rri besnik muzikës. Në Preshevë e rrethinë luheshin këto valle: Preshevka, Bilaçka, Miratocka, Deli Agushi, Dimka, Pembe-Pembe, etj. Muzikantët, vallet i përcillnin edhe me fjalë, kinse këndonin, pak në një formë tallavaje. Vërehej se edhe valltarët, por edhe shikuesit kënaqeshin me këtë muzikë të çoroditur.

Në Preshevë, ka ndodhur që valltarët duke lozur valle kanë kërcyer edhe nëpër dritare kanë dalë në oborr (Jahi Bushtrani dhe shoku i tij, Abdurrahman Sahiti, i njohur si aga Dushi). Në fshatrat Rahovicë, Rincë, Miratoc, Corroticë, Bushtran etj. ka pasur valltarë të shkëlqyer. Edha Malësia i ka pasur valltarët e vet. Gjithashtu edhe në vetë qytetin e Preshevës kanë shkëlqyer valltarët.

Siç cekëm edhe më herët, muzikantët kanë qenë të minoritetit rom. Ata i kanë përdorur këto vegla muzikore, si klarinetën, fizarmonikën, violinën, kitarën, defin dhe darabukun (tupanin).



Vallja e Dimkës e luajtur në Bullgari, kjo valle edhe sot, luhet nëpër dasma në Preshevë



Një valle në Malësinë e Preshevës

(Feris Seferi, Orhan Shabani, Sadri Sadriu)



Një valle në Sh K "Abdulla Krashnica"

Një valle para komitetit në Preshevë

Ka qenë zakon se të gjitha grupet muzikore jevge, me vete e merrnin edhe ndonjë femër rome që kinse luante çyçek. Kjo bëhej pas valleve të burrave. Ajo, valltarja çohet e luante duke u dredhur e përdredhur dhe i binte përpara dasmorëve, e ata të ngazëllyer i ofronin para. Ka pasur edhe zënka ndërmjet meshkujve për kërcimtarin. Ajo mbulohej me para... Shpesh edhe gjatë valleve janë dëgjuar edhe krisma armësh. Vlen të ceket se në Preshevë e rrethinë shumë pak e mos të themi fare pak përdorej alkooli. Vetëm nga një litër raki ia siguronin muzikantëve romë. Mirëpo, ka pasur raste që kanë pirë edhe dasmorët tjerë, e kjo ka ndodhur, sidomos kur janë martuar intelektualët.

Është interesant se në vetë qytetin e Preshevës fort pak janë bërë **dasmat me daulle**. Para viteve të 60-a të shekullit të kaluar në Preshevë, ka qenë edhe një daullexhi me dy zurlaxhi e më vonë vinin prej vendeve tjera. Këta ishin romë. Sot vetë në Preshevë janë dy grupe daullexhi, që shkojnë nëpër dasma. Të dy grupet janë shqiptarë dhe vishen me uniformë shqiptare.

Edhe pse, në të gjitha trevat shqiptare, në dasma kanë kënduar edhe këngëtarë me

çiftelia, sharkia, fyej etj. ndërsa në Preshevë e rrethinë nuk janë parë thuajse fare. Më herët dasmat për burra kanë zgjatur dy net, ndërsa më vonë vetëm një natë.

Pas gjithë këtyre këngëve e valleve, rreth orës 3 e katër të mëngjesit, pra duke u zdritur, edhe dasmorët shkonin në shtëpitë e tyre. Zakonisht, mysafirët përcilleshin me muzikë, që i thoshin "Gaziler". Dikur, kur bëheshin dasmat e burrave dy net, vlen të shënohet edhe kjo se në disa vende organizohej edhe prurja e bakshisheve "dhuratave". Kështu në mënyrë të organizuar paraqiteshin fëmijët 10-13 vjeç me shkopinj të gjatë në dorë, ku miqtë i vënin peshqeshet e tyre, domethënë ato që i kishin prurë për dasmë. Në shkopinj kishte para, basmë të ndryshme e ndonjëherë daja e binte ndonjë dash etj. Ata, peshqeshdhënësit fëmijëve u jepnin edhe para. Në mënyrë të organizuar me muzikë niseshin nga konakët e burrave për në shtëpinë e dhëndrit, ku i priste babai apo vëllai më i madh i dhëndrit. Kur mbërrijnë peshqeshet, babi e merrte peshqeshin dhe fëmijëve u jepte të holla. Kështu vazhdon deri te fëmija i fundit. Ky ishte gëzim edhe kënaqësi edhe për fëmijët.

K r e u VII

DASMA E VAJZËS – KANAGJEGJI

Si në shtëpinë e djalit edhe në shtëpinë e vajzës fillon dasma në të njëjtën ditë. Pasi t'i kenë pruar petkat (ditën e mërkurë) vajza së bashku me shoqet e afërta bëjnë shtrirjen e çejzit. Pra ato, në mënyrë mjaft profesionale (të mërkurën) në dhoma e shtrijnë pajën, për ta parë të tjerët. Çdo gjë që ka punuar vajza me vite atë ditë i radhisin. Madje ka edhe punime të dorës që i kanë punuar edhe shoqet, nënat dhe gratë e tjera, sepse vajzës, që shkon nuse është si traditë t'i ndihmojnë të gjitha.

Në Luginën e Preshevës, fjala **Kanagjegj**, deri vonë s'është dëgjuar, kjo fjalë ia mbërrini para 20 vjetësh. E sollën vajzat, që shkolloheshin në Universitetin e Kosovës. Këtu është përdorur togfjalëshi **Dasma e Çikës**.

Ditën e enjte, praktikisht fillon edhe dasma. Kjo ditë në popull njihet si dita e bojës (edhe pse u interesuam shumë, por askush nuk diti të më sqarojë pse i thonë dita e bojës). Pra, në mëngjes, dy apo më tepër vajza, që janë me prindër dhe ndonjë nuse a bijë të kënaqura ia veshin rrobat e nusërisë, që ia kanë pruar nga ana e burrit. Ato njëkohësisht edhe këndojnë këngë. Madje një nuse e martuar, apo bijë, fillon edhe të qajë si nuse e pastaj asaj i bashkohet edhe vajza, që shkon nuse. Deri sa në Kosovë vajzat që shkojnë nuse, qajnë me oi,oi,oi, këtu në Preshevë e rrethinë qajnë me uh,uh,uh,(hu-hu-hu) pra u-ja dhe h-ja përzien e kështu qanë ajo nuse e me të edhe vajza. Pra kështu nusja e mëson se si duhet të qajë vajza. Pas pak pushojnë, vajza e heq fustanin e burrit dhe përsëri vishet me rrobat e çiknisë. Ajo gjatë kësaj dite vetëm rri me shoqet, me mbesat dhe farefisin e gjerë. Shoqet e vajzës ia fillojnë me këngë:

Mytna tu kajtë

(Ashan, Preshevë)

Mu kon si Fatmirja mytna tu kajtë,

Po kujton e e shkreta se po shkon te dajtë,

Nuk po shkon te dajtë me pushue,

Po, po shkon te burri me punue,

Nuk po shkon te dajtë për dy-tri net,

Por, po shkon te burri për shumë vjet!

Kjo këngë është shumë e moçme. Thonë se u këndua edhe para Luftës së Dytë Botërore. Kjo këngë edhe sot është aktuale. Kështu ato ia përkujtojnë vajzës se te burri s'është edhe aq mirë, dmth. s'është si kur shkon te dajat, për atë arsye edhe nusja duhet të qajë, ende pa e mbaruar vajzat këngën, vajza fillon të qajë.

Gjithashtu ato ia përkujtojnë asaj se s'po shkon te burri për dy-tri net, por po shkon për tërë jetën. Kjo këngë këndohet në gjithë Luginën.

Shoqet në disa këngë e përdorin edhe shpotinë, si: A di motër...(Zhunicë, Preshevë).

A di motër kur të vogla ishim,

Ani gjithmonë lujshim e rrishim.

Ani kur u rritëm të mëdha,

Kemi pasë lidhë besë mos mu da,

Poti motër besën e theve,

Theve besën e msheft po qeshë,

Ani n'tesha t'grave sot je veshë.

Kjo këngë edhe pse këndohet në çdo dasmë në Preshevë e më gjerë, zanafillën e ka nga Kosova, sepse ka qenë e shkruar në tekstet shkollore për shkollat e mesme (Lexim letrar kl.I, autor Abdullal Zajmi...). Kështu nxënëset e kanë lexuar dhe më vonë e kanë kënduar nëpër kanagjegje.

Për ta bërë nusen që të qajë më shumë, vajzat e ndërrojnë pak stilin e këngëve, kështu vazhdojnë:

Kaj moj Lule

Kaj moj Lule nëpër ara,

Kush i del dajve përpara?

-Po ju la motrës amanet,

Let ju del ajo çysh ju kam dal vetë.

Kaj oj Lule kaj se shkove,

Dy here ne gryk nuk na more.

Kaj oj Razë

(Maxhere, Preshevë)

Kaj oj Razë e ule tokën,

A të merr ty malli për motrat?

Më mer malli e shumë e due,

Se shumë të mira janë konë për mue,

Vishnja prej rrojës thahet,

Çika prej nonës po dahet,

Kaje moj nonë bijën o,

O kush ta fshin ty shpijën o...

Kënga e cekur daton herët. Edhe sot këndohet në gjithë trevën. Këtu vihet në pah dashuria madhe ndaj motrave. Në strofën e fundit kemi dy vargje pak më ndryshe. Aty paraqitet dashuria madhe ndërmjet nënës dhe vajzës, ku në mënyrë metaforike na e paraqet tharjen e vishnjës me ndarjen e vajzës prej nënës. Kështu këngët s'kanë mbarim. Por për t'ia ndalur vajzës vajin i këndojnë dy vargje tjera:

Sha ka Drita ç'i po kan,

Ju kish flliç vjehrra e sun pe lan...

Siç verehet, këngëtalet popullore, kanë menduar shumë mirë, kur duan ta ndalin të qarët e vajzës. Ato me dy vargje e bëjnë që vajza të pushojë, dmth. vajza po qan, sepse vjehrra e saj është fëlliqur. Edhe kjo këngë është kënduar që nga viti 1940.(kështu ka informuar Selville K. Rexhepi, e lindur rreth vitit 1905).

Këtu vajza e ndërpret të qarët. Dasma vazhdon...

Të premtën, herët në mëngjes, vajzën e vesh veshatorja, vajzë apo nuse, që caktohet dhe ajo vazhdimisht kujdeset për veshjen e nuses. Vajza herët në mëngjes fillon të qajë e t'i vajtojë njerëzit e shtëpisë, bijat etj. Ajo një nga një i merr ngryk duke qarë dhe duke i vajtuar dhe duke ia numëruar të gjitha të mirat dhe të këqijat që i kanë përjetuar së bashku gjatë kohës së vajzërisë. Vajza që shkon nuse duke e përqaftuar të vëllanë vajton e i thotë : " vlla, vlla, loçko vlla a shumë t'u mërzita që po më largoni prej shpisë vlla. Kur të shkojsh në fushë a do të bjerë në mend për mu, kur të shkoni te vneshti si do të j'u duket pa mu..." Këto fjalë i radhit duke i përcjellë me të qara uh-uh-uh. Kështu vazhdon me radhë, i vajton të gjithë anëtarët e familjes dhe njerëzit tjerë që janë aty. Duke qarë e vajtuar, edhe njerëzit e pranishëm fillojnë të qajnë, sepse është moment shumë prekës. Vazhdimisht vajzat këndojnë, si:

Kaj motër ...

(Leran, Preshevë)

Kaj motër kaj, fustanin me tel,

Kur t'vijmë hallat para kush i del,

Para kush i del, mrenda kush i shti,

Kush i shërben motër sikur ti...

– Po ja lo motrës amanet,

Le t'kujdeset si kur jam kujdes vetë...

Kjo këngë e dhembshme, sipas Hajnishahe I. Ibishit është kënduar rreth vitit 1965 e këndeje. Këtu rrëfëhet se si hallat, kur kanë ardhur në gjini, i kanë pritur dhe i kanë shërbyer vajzat e rritura. Pra, kur të shkojnë këto nuse s'ka kush kujdeset për bijat. Mirëpo, sipas këngës, ato s'duhet të brengosen sepse ia ka lënë amanet motrës që do të kujdeset për bijat...

Ndodh që vajza e ka babanë të vdekur, kështu vajzat edhe për atë thurin vargje p. sh.

Kaj moj motër. kaj n'oborr

(Rahovicë, Preshevë)

Kaj moj motër, kaj n'oborr,

Le t'nije baba atje në vorr!

–Ani ka po vjen ky za i rondë,

Ani çika jeme nuse po shkon,

Ani hajt oj bijë he udha marë,

Ani se s’po m’le mue dhevi me dalë...

Edhe pse këngë të tilla këndohen më rrallë, por përsëri edhe ato e kanë vendin e vet. Vajzës, që i ka vdekur babai, kur ta dëgjojë këtë këngë, vërtet qanë me lot. Tash thuajse këngë të tilla s’këndohen më.

Në këtë çast vajza e shton të qarët edhe më tepër, madje qajnë edhe gratë tjera. Shoqet e vajzës s’pushojnë fare, ato vetëm këndojnë.

Sidomos, për vajzën, që i ka prindërit, si p.sh:

Kaj Lulije lot si gruni

(Norcë, Preshevë)

Kaj lulije motër lot si gruni,

Ani shka pat baba ç i t’ përzuni.

Ani unë babës ju mërzita,

Ani për Bajram fustan i lypa.

Nusja pas çdo strofe qan...

Kaj lulije motër n’prag të derës,

Kujt po ja le lulet e verës?

Po ja lo unë motrës amanet.

Let ‘i kshyre sikur m’u konë vetë.

Informatorët na thonë, se kjo këngë, zanafillën e ka rreth vitit 1945, po që edhe sot këndohet.

Siç po shihet, edhe pse disa këngë janë në formë dialogu, por aty s’zhvillohet kurrfarë dialogu, sepse vajzat këndojnë vetë dhe dialogun e imagjinojnë vetë.

Kaj , Lulije, N'shami t'mavit

(Rahovicë, Preshevë)

Kaj, Lulije, n'shami t'mavit,
kshyri arat ka i ke prashitë,
ka i ke prashitë me vllazni;
me hoka na s'jemi ngi.

Kaj, lulije oj motra jonë,
kshyri shoqet ka i ke lanë.
Shoçe shoçe jena boll,
për Lulijën na s'jena n'zor.

**-Kaj, Lulije lot si gogël,
se po t'presin krushqit n'kodër.**

- Hajt ne t'presin sa kanë pritë,
sa ta marr unë nanën ngrykë

Kaj, luli, shaminë me tel,
motrës para kush i del?
Kush e shtin mrena në shpi?
- N'mos kofsh ti, ajo nuk hi.
Kaj, lulije, hu e hu,
mjera ti ku ki me shkue
me ni kodër e m'ni prrue,
t'pikin lendat tuj gatue,
pite nanës tu'i maru.

Në këngën “Kaj Lulije n’ shami t’ mavit”, vajzat këndojnë që të hipë sa më shpejt në qerre, se po e presin krushqit, pastaj kënga vazhdon se sa të përshëndetet me nënën.

Zakonisht, vajzat bëhen se qajnë, pra qajnë pa lot. Pasi shoqet e vajzës i dinë këto truqe, andaj me këngë e porosisin nusen që të qajë me lot e të mos tallet, sepse s’do të shihen një kohë të gjatë. Kur i dëgjon vajza këto fjalë fillon të qajë edhe me lot. Kjo vërehet te kënga “Kaj, moj çikë, mos kaj me hoka”, që është marrë nga fshati Tupallë të Medvegjës.

Kaj, moj çikë, mos kaj me hoka
(Tupallë, Medvegjë)

Kaj, moj cikë, mos kaj me hoka,
kaj me lot dej t'ulet toka.
Bane tokën balt me lot,
se s'shimi dej tash motmot.

Kaj, oj motër, o hastret,
se s'shimi dej tash dy vjet.
Kaj, moj cikë me lot në sy,
mall e kem' me u knaçë me ty.
Kaj, moj cikë, gjith tuj lotue,
kurr ma bashkë s'kena me lue.
Kaj, moj motër, kaj moj bi,
tash na u bane jabanxhi.

Për ta treguar edhe dashurinë e vëllait për motrën, ato vazhdojnë:

O ky vllavi jot' ka bo be
(Corroticë, Preshevë)
O ky vllavi jot ka bo be,

O tona hijet ka me i pre,

O ka me i pre e ka me i krasit,

O ka ka hecë motra jeme cikë...

Edhe shumë më herët dashuria e vëllait për motër është parë në shumë këngë, kështu që kjo vetëm edhe një e vërteton këtë, që e thamë më lart. Po e cekim se kjo këngë më nuk dëgjohet.

Si në këtë katrenë edhe në shumë këngë tjera vargjet fillojnë me zanore O, me qëllim që të rritet zëri dhe t'i shtohet muzikaliteti.

Kah dreka fillojnë të vijnë vajza e gra nga mëhalla, fshati etj. për ta parë çejzin (pajën) Vijnë edhe miqësia. Ato në imtësi i shikojnë gjërat e punuara, duke bërë edhe krahasime me punimet e vajzave tjera. .

Në mbrëmje njerëzit e shtëpisë dhe magjetolet kanë përgatitur darkën për gratë e ftuara. Ato vijnë dhe i pret nusja (vajza). Të gjitha, me radhë i merr në gryk

e disa edhe i vajton, pra qan dhe aty për aty improvizon fjalët për secilën me radhë. Në darkë, vajza që shkon nuse, i ndihmon nuseve të tjera për t'i shërbyer të ftuarve. Është interesant se kjo vajzë (nusja) gjatë darkës disa vajzave beqare ua merr kafshatën e bukës nga dora. Me tendencë që ato t'i marrë më vonë nuse për familjarët e burrit.

Gjatë ditës dhe pas darke, vazhdimisht shoqet këndojnë këngë, ku shpesh janë edhe prekëse. Zakonisht ato i fyejnë, përqeshin, pak burrin e më së shumti familjen e burrit e kryesisht vjehrrën. Tash për ta vazhduar nusja vajin, shoqet përsëri e fillojnë me këngë:

Ani na ka çue dhondrri fjalë,
Ani thuni lulijes të mos kajë.

E tash nusja, kinse për inat të dhëndërit fillon të qajë. Vajzat i kujtojnë asaj punët e fushës:

Kaj moj motër me shami t'mavit,

Dil e kshyri arat ka i ke prashit.

Ka i ke prashit e ka i ke punue,

Ani shatin tond ku e kanë ndue.

Kjo këngë, më tepër i dedikohet kohës, kur vajzat kanë punuar nëpër ara, për këtë arsye kjo e simotrat e saj nuk dëgjohen më.

Oj Lulije flokët me ni anë
(Bushtran, Preshevë)

Oj lulije flokët me ni anë,

Erdhi koha me i lan babë e nanë,

Oj lulije po shkon n'atë kodër.

Sot po ndahesh me vlla e me motër.

Kaj Elvije, lot si gruni
(Preshevë)

- Kaj Elvije lot si gruni,

çka pat baba ç'i t'përzuni?

- Une babës ju mërzita,
për Bajram fistan i lypa.

- Kaj Elvije lot si gruni,
çka pat baba ç'i t'përzuni?

- Une babës ju mërzita,
për Bajram xhaket'i lypa.

Të shtunën në mëngjes vajza, që shkon nuse me disa përcjellëse shkon te mixhallarët e te kushërinjtë dhe i vajton anëtarët e familjeve të tyre. Ajo gati se i thotë të njëjtat fjalë që ua thoshte edhe njerëzve të tjerë. Kështu duke qarë me shami në kokë, që ia mbulon edhe fytyrën i merr në gryk, qan e vajton. Ajo u thotë se si do ta ndjejnë ata vetën pa vajzën e tyre, që po shkon nuse. Kur do të zgjohen në mëngjes, si do të sillen, kur e shohin se vajza e tyre nuk është më në mesin e tyre, kur do të shkojnë te shtëpia e prindërve të saj a do t'u vijë keq kur e shohin se ajo më nuk është në shtëpi, pastaj vajton e thotë se kush do t'ju presë, kush do t'ju qesë ujë dhe kush do t'ju shërbejë. Pra, ajo qan, po edhe të afërmit e saj nga fjalët drithëruese i bën të qajnë. Kjo vazhdon me radhë, po them sinqerisht se aty ka mjaft lot, pra bëhet një vaj i vërtetë nga të gjithë. Pas dreke përsëri vijnë vajza e gra për ta parë çejzin.



Preshevë 1994

Aty ka edhe shumë nuse të tjera të familjes. Vajzat këndojnë vazhdimisht këngë dasmash, për shoqen e tyre të dashur që po shkon nuse dhe për nuset e pranishme. Kur është fjala te nuset, ato vazhdimisht bëjnë temena (përshëndetje) sepse nëpërmjet këngëve, vajzat i porosisin nuset ta kryejnë atë përshëndetje nusërore për nder të vjehrrave, kunetërve, kunatave etj. Pasi nuset e kryejnë përshëndetjen në mënyrë shumë delikate e me naze, këngëtaret me këngë i përshëndesin nusen që bën temena dhe e lavdërojnë atë:

Ani mirë e bane mirë e dite,

Ani vjehrrën tonde s'e korite.

Siç po shihet se ky distik (dyvargësh) përsëritet më së shumti. Pastaj e nxitur nga këngët e vajzave, vajza qan dhe i merr në gryk edhe gratë të tjera, që janë në dhomë. Ajo për secilën prej tyre qan me uh- uh- uh dhe improvizon vargje aty për aty në forma të ndryshme vajtimi.

Nata e Kanës

Të shtunën në mbrëmje, te ne e njohur si: "Nata e Kanës" vijnë gra, të ftuara

në shtëpinë e vajzës, për darkë. Këto i pret edhe vajza (nusja). Pos farefisit janë të ftuara edhe gra nga miqësia. Ka plaka dhe të reja, pra mosha të ndryshme. Natyrisht bijat, mbesat e kushërirat llogariten si njerëz të shtëpisë. Respekt të madh kanë gratë e ftuara. Ato përcillen deri te dhomat e ndejës. Vajzat dhe nuset e shtëpisë i kanë punët e ndara, kush duhet të shërbejë nëpër dhoma, kush i merr këpucët etj. Në këtë kohë grave nuk u ofrohet asgjë për të pirë e për të ngrënë.

Magjetoret dhe gjellëtoreset i kanë bërë të gjitha gati për darkë. Shërbyeset vazhdojnë të shtrojnë darkën. Për darkë përgatitet çorbë, fasule, jani, mish e oriz, ndonjë byrek, ëmbëlsira (tatli ose bakllava). Së pari nuset dhe vajzat vijnë me legenë e me ibrikë për t'i larë gratë duart. Shtrohet sofrabezi e mbi to sofa. Gratë afrohen dhe ulen e ngushtohen sa më shumë. Së pari, në sofër vihet çorba (supa) dhe sofa mbushet me bukë. Dikur të gjitha gratë kanë marrë çorbë me lugë prej një pjate që quhej sahani çorbës dhe dallohej prej enëve tjera. (sot secila grua ha, veçmas në pjatën e vet)

Shërbyeset, kur vërejnë se gratë s'hanë më, e heqin enën me çorbë dhe e vënë tavën e dheut apo të "çinkës" me fasule. Derisa gratë hanë, një nuse rri gati me gotën ujit në dorë dhe i shërben gratë me ujë. Të gjitha pinë prej të njëjtës gotë. Pas fasules e bien janinë (gjellë me mish, qepë, bizele etj), në radhë është tepsia me mish e oriz. Nganjëherë ofrojnë edhe pite (byrek). Tatlia (rrallë ndodh edhe bakllava), në fund kemi tomëloriz (sytliaç). Është interesant, se te gratë thuajse asnjëherë, pas drekës ose darkës, nuk bëhet "amini" (lutja e bukës).

Pas darkës në një mënyrë vazhdon dasma, por me një zymtësi. Dikur në dhomë, vjen një grua e martuar, me një enë me kanë dhe afrohet te nusja për t'ia ngjitur kanë. Vajzat ia krisin këngës.

Ani kaj oj motër

(Geraj, Preshevë)

Ani kaj oj motër në skej të janit,

Ani ty t'ka lonë nata e Bajramit,

Ani tona çikat na kur t'mblidhmi,

Ani mori motër edhe ty t'thirrmi.

Kaj Hyrije n'jastëk t'nonës

(Rahovicë, Preshevë)

Kaj, Hyrije, n'jastëk t'nonës",

-Kuku, nonë, nata e konës!

- Shka t'boj nona, ori bi?

Si tanë shoqet edhe ti.

Vajza mërzitet se i erdhi koha të ndahet nga shoqet, ndërsa nëna i jep zemër, duke i thënë, se si të gjitha shoqet, do të martohesh edhe ti.

Kaj Lulë me shami

Perendoj dilli e doli hana,

Ka ardhë koha me u ngjit kana,

Kaj oj lule me shami,

Po të ban nana jabanxhi,

Kaj oj Lulije me jelek,

Cysh pe le shpijën vet.

Edhe pse në të gjitha këngët, burri lavdërohet, por kemi edhe raste kur dhëndri përqeshet, si p.sh.

Kaj Hyrije, kpute telin

(Tërrnavë, Preshevë)

Kaj Hyrije, kpute telin,
se p'e merr-o Jusuf qelin.

Jusufi qeli, kur t'bjere borë,
qelat-o i krun me dorë.

Ky Jusufi kur t'bjere shi,
O i krun qelat me kashagi.

Në këtë strofë, këngëtalet na bëjnë edhe të qeshemi , sepse dhëndrin na e paraqesin, se kinse i ka qelat dhe kur të bie borë, ai i krun qelat e kur të bjerë shi i krun me kashagi (mjete me të cilën krehen kuajt). Ndërsa në vazhdim vajzat nëpërmjet vargjeve thonë se po i dhimbsej shoqja e tyre se ka për të shkuar në një vend të keq, në një kodër e në një përrua.

Në një strofë tjetër, e paraqesin se shoqja e tyre, që po shkon nuse, po këqyr arat

kah ka punuar me vëllezër, duke folur e duke qeshur.

Kaj Hyrije n' shami t'Sarit

(Raincë, Preshevë)

Kaj Hyrije n'shami t'saritë,
kshyr arat ka i ki prashitë;
ka i ki prashitë me vllazni;
me llaf e gaz s'un je ngi.

Kaj Hyrije hu-hu- hu,
mjera ti ku ki me shkue-
në ni kodër, në ni prrue,
në ni pleme tuj timue.
pikin lenat tuj gatue;
skaj shkon reka tuj ushtue.
Zemra jote ka m'u trishtue.

Shoqet duke kënduar e bëjnë që nusja t'i heqë rrobat e nusërisë.

Oj motra jonë nën hijen e blinit,

Ti e desh fustanin e llatinit.

Pasi , nusja, duke qarë e heq fustanin, shoqet vazhdojnë:
N'ja paç hatrin ti babës o,

Fustanin e çet me ni onë,

Dhe tri herë e shkel me komë .

Vajza, vepron sipas porosisë së këngës, duke e shkelur fustanin tri herë me këmbë.
Kështu vajzat e vazhdojnë këngën për të gjitha rrobat, që i ka veshur e ajo e respekton këngën , duke i hequr dhe duke i hedhur rrobat anash.
Pastaj fillojnë t'ia vënë kanën me këngë:

Ani mori motër e bija e trimit,

Ani çysh po e nxhet konën e llatinit.

Tash nusja reagon kinse nuk dëshiron t'i vihet kana. Pastaj vazhdon një rit tjetër që

edhe ky përcillet me këngë, duke i thënë nuses se çka po i le babës dhe të tjerëve ndonjë shenjë për mall.

Ani kaj moj motra jonë kaj.

Ani shka po i len nonës për mall,

Po ja lo pesë gishta konë.

Kështu ngritët nusja dhe lë gjurmë të gishtave në mur. Kënga vazhdon gati për të gjithë anëtarët e familjes dhe vajza lë gjurmë gishtërinjve në mur. Këto gjurma mbeten deri sa ta gëlqerosin dhomën.

Riti i ngjitjes së kanës dhe këngët për të zanafillën e kanës, mendohet se janë nga shekulli XIX.

Kënga vazhdon:

Ani kaj moj Dritë e shashtrisu,

Merre nonë n'gryk e hallashtisu...

Nusja merr në gryk dhe qan e vajton. Këtu, sigurisht, vërtet qan, se moment mjaft i prekshëm. Kështu nusja vazhdon t'i marrë ngryk e t'i vajtojë, motrat, hallat, gratë e mixhallarëve, tezë, kushërirat, shoqet etj... Kjo bëhet me një rend të caktuar, pra vajzat këndojnë dhe me këngë e porosisin nusen që me radhë ta kryejë këtë ceremoni.

Më vonë të gjitha gratë e familjes, bijat e mbesat, kushërirat etj. angazhohen për ta bërë gati për të nesërmen. Disa vajza caktohen që të fillojnë me mbledhjen e çejzit (pajën) për nesër. Një pjesë të çejzit e vënë nëpër arka, e cilat janë të ndërtuara nga materiali i drurit). Ato pajën e rregullojnë duke e palosur në mënyrë delikatese, se e njëjta pajë duhet të shtrihet edhe në shtëpinë e dhëndrit, kur të shkojë nusja. Gjatë palosjes së pajës merr pjesë edhe vajza që shkon nuse. Kur kryhet rregullimi i pajës, atëherë vajza që shkon nuse bëhet gati për gjumë. Atë natë ajo mbulohet me jorgan të ri të burrit ose të vetin që ia blen babai. Te ne thuhet se prindi i vajzës duhet vajzës t'ia blejë një jorgan dhe dyshek, që në rast të zënkës me burrin, burri mund ta largojë nga shtrati, e ajo mund të mbulohet me jorganin e vet të bërë dhuratë nga babai i saj. Pra, këtu shihet një gjë, që është e menduar shumë mirë.

Me vajzën atë natë fle edhe ndonjë djalë i vogël i familjes, domethënë ky akt është një parapërgatitje për ditën e nesërme që do të shkojë te burri, pra bie në shtrat me një fëmijë mashkull. Kështu të gjithë bien të flenë e të pushojnë pas një

lodhjeje të madhe. Kuptohet ato e dinë kohën se kur do të vijnë krushqit.

Familja e vajzës në mëngjes herët zgjohen nga gjumi. Vajza është edhe e lodhur edhe e prekur. Siç e kemi cekur edhe më lart, se për veshjen e nuses caktohet veshatorja, që kujdeset gjithnjë për pamjen dhe veshjen e nuses. Atë e bëjnë gati e lyejnë e ngjyejnë dhe e “teleisin”. Disa studiues thoshin se më herët nusen nuk e kanë veshur e “teleisur” për ta bërë të bukur, por e disa thonë se duhet ta bëjnë sa më të shëmtuar që të largohen gjërat e liga.



Rahovicë 1984 veshje me dimi.

Më herët në trevën tonë nusen e kanë veshur me dimi dhe në kokë ia kanë vënë 2 metra basme tekstili, në të shumtën e rasteve basma ka qenë me ngjyrë të kuqe ose edhe me lule.

Pra, të gjitha këto bëhen gati para se të vijnë krushqit.

Në qytet vajzën (nusen) e kanë përcjellë natën, rreth orës 3 të mëngjesit, dmth. pa lindur dielli. Edhe pse jemi përpjekur të mësojmë për këtë gjë specifike s'kemi marrë ndonjë arsye të shëndoshë. Kështu që erdhëm në përfundim se kjo më tepër bëhej që të dallohen nga shtresat e tjera apo ndoshta që në qytet mos të bëhet tollovi.

Nisja e qerreve

Më parë caktohet ora se kur do të nisen qerret për ta marrë nusen. Zakonisht, qerret e bëra gati që në mbrëmje tash vetëm pak kohë duhet. Burrat dhe gratë e qerreve janë gati. Krushkat hipin në qerre. Në bisedë e sipër, Xh. Rexhepi më ka thënë se gruaja, që ka hipur në qerre është dashur edhe burri i saj ose ndonjë i afërt nga familja e burrit. Kjo rregull nuk ka vlejtur për bijat, sepse dhëndurët (burrat e bijave) s'kanë shkuar për të marrë nusen. Atëherë kur të gjithë të jenë gati

qerret nisen dhe kënga s'ka të ndalur, madje një vajzë ose djalë, rrotave të qerres së parë u hedh ujë.



Derisa hipin krushkat kënga e muzika nuk hesht, defatoret dhe vajzat e bëjnë gjymyshin më të madh. Ato këndojnë:

Ne i nisim kerrat

(Norçë, Preshevë)

Ne i nisim kerrat pa le hona,

I xhejmë rohovicalitë ndër jargona.

Veç babxhysh derri ish kon çu,

Cohu oj gru se na paskan rrethu.

Kjo këngë, siç na tha gruaja 82 vjeçe (Ajnishahe Ibishi) ..., e kanë kënduar gratë edhe para saj.

Pra edhe nëpërmjet të këtyre rreshtave mësojmë se krushqit, duke kënduar janë nisur herët në mëngjes, me qëllim që të mbërrijnë para drekës.



Lezbali 1984 Topallë, Medvegjë

Janë nisë kerret mlue me t'kuç
(Rahovicë, Preshevë)

Janë nisë kerret mlue me t'kuç,
para i shkojn-o treqin krushq:
treqin krushq-o me bajrak.
Rrehin surlat për merak:
bjen daulli dum e dum.

Krushkat n'kerr thojnë: "Lum e lum,
lum e lum-o për këtë ditë,
shyqyr zoti s'na ka koritë!

Nisu kerr –o, nisu Lule
(Rahovicë, Preshevë)

Nisu kerr-o, nisu lulë,
t'u kanë nisë krushqit për udhë.
Qaj ma i pari, qaj ma i miri,
kunati i lules, gojbylbyli.

Nisu kerr-o, nisu lulë,
t'u kanë nisë krushqit për udhë.
Çaj ma i pari çaj ma i miri,
mixha i lulës, gojbylbyli.

Duke u bazuar në fjalët e profesor, Xhemaludin Rexhepit, po e japim edhe një rast, që për Preshevë është i vetëm (unikat). Në vitin 1962, kur u martua mësuesi, Ismail Ibishi, (Mësues Malushi) nga fshati Norçë. Krushqit u nisën me dy qerre me krushka. Si rëndomë qerret ishin të mbuluar me qilima të kuq dhe para e prapa ishin me çarçafë të bardhë. Kur mbërrimë tek udhëkryqi te “**Centralla**” dalin dy policë serbë (Gaiqi me një tjetër), i ndalojnë qerret dhe thonë se ç’keni në qerre. Burrat u sqarojnë se kemi dasmë dhe po shkojmë të marrim nuse në Rahovicë. Policët vazhdojnë me të tyren dhe urdhërojnë të zbulohen qerret, se s’dihet se ç’keni aty. Burrat kundërshtojnë dhe atëherë afrohet krushku **Saqip M. Saqipi** (kushëri), i cili punonte në Kuvendin komunal dhe e njihnin policët. Ai me dorë e ngriti çarçafin dhe i tha se a po e shihni që ka gra. Ata u zmbrapsën, e ne vazhduam rrugën. (Atëherë unë isha në klasën e tetë , 15 vjeç)

Vlen të thuhet se dhëndri asnjëherë s'ka shkuar me krushqit, por ai ka mbetur në shtëpi. Pra, atij ia kanë sjellë nusen në shtëpi, madje deri vonë edhe vjehrrin nuk ka shkuar me krushqit, por është interesuar rreth rendit në shtëpi.

Tash do të përpiqemi të themi diç për dhëndrin që ka mbetur në shtëpi.

Me të është caktuar të rrijë një grua e afërt e familjes. Ajo kujdesej për të dhe vazhdimisht e ka në përcjellje, që mos t'i ndodhë diç ose ta ruajë mos t'i bëjë kush ndonjë magji.

Ndërkohë dhëndri shkon dhe rruhet te berberi (rrojtari) ose e rruajnë shokët në shtëpi. Pastaj në shtëpi të vet lahet e pastrohet, i vesh rrobat e dhëndërisë. Vazhdimisht afër i rri ajo gruaja e besueshme, që është caktuar nga rrethi familjar i dhëndrit. Ashtu i veshur e i pispillosur, largohet pak prej shtëpisë. Atë e shoqëron ndonjë mashkull i afërt që duhet të jetë i martuar më herët. Ai e luan rolin e mësuesit, të këshilltarit, dmth. e mëson dhëndrin se si duhet të sillet me nusen gjatë natës së parë dhe ceremonive të nevojshme.

Në shtëpi të vajzës

Në shtëpinë e vajzës të gjithë janë bërë gati për pritjen e krushqve. Pritja bëhet në dy shtëpi, pos shtëpisë së vajzës bëhet gati edhe një shtëpi për burra, dmth. se gratë janë të ndara prej burrave. Shtëpia ku rrinë burrat kryesisht ka qenë shtëpia e axhëve të vajzës apo ndonjë të afërm të ngushtë të vajzës. Edhe këtu caktohen detyrat për të gjithë. Meshkujt dalin për t'i pritur qerret. Gjatë

përshëndetjes, burrat nisen për në konakun e tyre dhe qerret ua dorëzojnë njerëzve të vajzës. Qerret me gra hyjnë në oborrin e nuses. Djemtë i "zhgedhojnë" qetë ose kuajt e i çojnë në stallat e shtëpisë dhe i japin ushqim. Pastaj të gjithë meshkujt largohen, atëherë fillojnë të zbresin krushkat.

Nusja prej dhomës e shikon vjehrrën nëpërmjet të një unaze me qëllim që t'ia marrë zemrën që do më thënë që ta dojë vjehrra më shumë.

Atyre u prijnë gratë e shtëpisë së nuses. Këtu kënga e muzika s'kanë të ndalur, po e theksoj se këndojnë vetëm krushkat. Kështu duke kënduar hyjnë në dhomë dhe vazhdojnë ceremonitë.

Tash fillojnë të këndojnë edhe shoqet e nuses. Ato këndojnë këngë shpotitëse, ku i sulmojnë dhe i ngacmojnë krushkat. Shpesh zhvillohen edhe këngë në formë dialogu nëpërmjet vajzave të shtëpisë së nuses dhe krushkave. Qeshën e përqeshën krushkat, por edhe ato ua kthejnë në mënyrë të njëjtë me këngë shpotitëse.

Ndërkohë krushkat fillojnë edhe të hedhin valle. Luajnë valltaret më të mira. pas disa valleve dhe këngëve ia fillojnë të vallëzojnë edhe nuset e shtëpisë së vajzës.

Pas këtyre këngëve e valleve dalin vajzat krushka e marrin nusen dhe e bien te krushkat. Nusen e përcjellin me këngë e muzikë, duartrokitjet nuk ndalen. Nusja ecë me hapa të vegjël ngadalë e me sy të mbyllur. Dy gratë e moçme e mbajnë për krahësh. Ato dy gra të familjes së nuses, deri diku të moçme dhe jo aq të bukura, me qëllim që mos t'ia marrin bukurinë nuses.

Më herët nusja ka qenë e veshur me dimi e para 50 - 60 vjetësh fillon të vishet edhe me fustan të bardhë. Mbi kokë ka pasur një basmë të kuqe, që i thoshin duvak.

Duke hyrë te krushkat, vajzat e qerres këndojnë:

Pa na thuaj Gjyshe...

Po na thuj gjyshe mire se kemi ardhë,

na ka çu Sabit aga çiken me ta marre,

Po na thuj moj lule mirë se kemi ardhë,

na ka çu Sabit aga ty me te marre...

Oj Lulije hec me sevda

(Rahovicë, Preshevë)

Oj lulije hec me sevda, hec me sevda

Cite ni hap e bon temena
Ani mirë e bone, mirë e dite,

Ani vjehrrën tonde s'e korite.

Duhet të cekim se edhe në fshatrat e Preshevës nganjëherë, në disa këngë, dëgjohet ndonjë fjalë që nuk është e trevës sonë. Kështu në fshatin Lezbali e dëgjojmë një këngë, që dallohet pre të folmes preshevare, si p. sh. bulla, prezore etj. Pastaj fjalët: divanhane, virane etj. Te ne i shqiptojnë si divanhone, virone etj. Pasi u interesuam, mësuam, se kjo këngë është kënduar nga mbesat, që na kanë ardhur nga fshatrat e Maqedonisë. Shembuj të tillë kemi shumë. Ja si ilustrim e kemi shembullin në vijim.

Çelni dyer, çelni prezore
(Lesbali, Preshevë)
Çelni dyer, çelni prezore,

kakan bullat llafatore.

Hajdni dalim n'divanhane,

kakan bullat fjalamane.

Çilni dyer, çilni dritare,

kakan bullat mahitare.

Le t'tubohen krejt mahalla,

t'i ngojnë bullat si cakalla.

Ori bullë, ori virane,

mshele gojën, hor u bane!



Lezbali 1984

Në këngën në vijim e shohim, se si vajzat në një mënyrë i përqeshin edhe djemtë e familjes së dhëndrit, madje edhe vetë dhëndrin. Në fillim i paraqesin si daullexhinj e kah fundi i këngës dhëndri na del edhe i lënë, i cili s'është në gjendje edhe macet t'i largojë prej përseshit.

ÇKA PI KQYR TI, DJALË, TAVANIN?

(Lezbali, Preshevë)

Çka p'i kshyr ti, djalë, tavanin?

Çou, shko n'dasëm, kap tupanin!

Ti, mos mujsh vetëm m'e cue,
thirr dhondrin me t'nimue.

Çka po kshyr, o djalë, përpjetë?

Çou, shko n'shpi e ban hyzmet!

Ti, mos mujsh sofrat me i cue,
thirr dhondrin me t'nimue.

Kape, djalë, dhondrin për veshi,

pritja macat pej përseshi.

Shko te dhondri, o bullak,

dil e luni nëpr sokak.

Në këngën e poshtëshënuar vërejmë, se si vajzat na e përshkruajnë nusen me duar të bardha në xham. Pas çdo vargu përsëriten fjalët “aman aman”, që pak a shumë e bëjnë këngën edhe më muzikale.

I ka çit Lulija durt e bardha

I ka çit Lulija durt e bardha n'xham,

çe ej aman aman durt e bardha n'xham,

Edhe po vet vjerren a e kam,

aman aman vjerrën a e kam.

Vjerrën e kie si hanëm zoja,

Përgatitja ti Lulije shamijën me oja.

Pra, siç po shihet prej kësaj kënge kuptojmë, se edhe pse vjehrrat janë të moçme, prapëseprapë i duan shamitë me oja, dmth. Kërkojë që nusja t'i sjellë peshqesh shami të punuar.

Do ta kallim po moj po
Do ta kallim po moj po,

Do e lojmë nonën pa çikë po moj po.
Do ta kallim Shkup e Shkodër po moj po,

Do ta kallim Shkup e Shkodër po moj po,

Do e lojmë vllaun pa motër po moj po.

Kënga e sipërme, është këngë më gëzueshme dhe këndohet prej vajzave me entuziazëm, sidomos muzikalitetin ia shtojnë fjalët “po moj po”, që përsëriten në fund të çdo vargu.

Është interesant se në letërsinë gojore shpesh këngët na dalin edhe përtej kufijve administrativë. Kështu në këngën më lart thuhet se do ta kallim Shkup e Shkodër...

KU KE OJ LULIJE

Ku ke oj Lulije që s'tkam pa kurrë,
Në Preshevë o shpijat me gurë.

Në Preshevë jetojshe, tentene marojshe,

E nër hije rrishe e pse te na nuk vishe.

Ku ke oj Lulije që s'tkam pa hiç,
Në Preshevë shpijat me qerpiq,
Në Preshevë jetojshe, tentene marojshe,
E nër hije rrishe e pse te na nuk vishe.

Kështu, vajzat këndojnë e nusja vepron sipas këngëve të shoqeve. Pasi kënga thotë “çite ni hap e bon temena”, pas hapit të parë e bën temenanë dhe pret vargjet tjera që të veprojnë sipas porosisë së këngës.

Kur të hyjë nusja në mes të dhomës, ia merr dorën djalit 5-6 vjeç, që është i vetmi mashkull, ai hedh mbi kokë dhe nëpër dhomë leblebia, ndërsa dy gratë e mbledhin bezin e kuq, ku ka edhe leblebia, sepse nuk guxojnë të bien në tokë. Kënga e defatoreve s'pushon fare. Në këto momente vjehrra është në qendër të vëmendjes. Edhe këngët sillen rreth personalitetit të saj. Ajo luan rolin një zonje të rëndë. Vajzat këndojnë këngë:

OJ LULIE HE GUGUTKË

(Corroticë, Preshevë)
Oj lulie he gugutkë,

Mjerrja vjerrës të dy durtë,

Të dy durtë e me ni krah,

T'boje vjehrra mashallah...

Kështu nusen , dy gratë, me respekt të madh, e afrojnë te vjehrra dhe ngadalë ia merr duart vjehrrës dhe disa grave tjera. Të gjitha këto bëhen me një butësi dhe krenari të madhe..

Shoqet dikur ua kujtojnë krushkave se a i kanë sjellë peshqesh shoqeve ku thonë:

ANI ORI KRUSHKA

(Bushtran, Preshevë)
Ani ori krushka shka jeni nguju,

hedije shoqeve a u keni pru.

Pastaj me këtë akt të këngës, ndokush prej grave të dhëndrit, ua dorëzojnë hedijet (peshqeshet). Vlen të ceket se familja e dhëndrit shoqeve të nuses, që këndojnë dhe që e madhështojnë ceremoninë e dasmës, u sjellin ndonjë peshqesh simbolik.

Kënga s'pushon dhe tash zhvillohet në formë dialogu ndërmjet shoqeve të vajzës dhe krushkave. Këtu nuk kursehen edhe thumbimet, por zakonisht më zëshme janë ato të shtëpisë së vajzës e krushkat, në këtë rast vetëm përgjigjen, si p.sh.:

OJ NANA DJALIT

(Raincë, Preshevë)

Oj nana djalit,
Xhaketin me lara,

Kshyre shfarë bukuroshe ,

Të ka dalë përpara.

Tash përgjigjen krushkat:

OJ NONA LULIJËS

(Raincë, Preshevë)

Oj nona Lulijës ,

Fustanin me vija,

Nuk e dini shfarë djali,

Kemi lonë te shpija.

Zakonisht shtëpia e burrit, pos tjerash i sillnin edhe qostek prej ari. E kur ndodhte që s'i kanë sjellë qostekun, vajzat këndojnë:

Ani ky Ademi hiç nuk kishte punue,

Ni qystek Ramizës nuk ja kishte prue!
Vazhdojnë krushkat:

Ndaluni niherë t'ja kshyrim marifetin,

E ne, mas dy jave do t'ja blejmë qystekin...

Në rast se familja e dhëndrit s'kanë bërë dasmë me harxhime, vajzat
me këngë i ngacmojnë krushkat:

OJ VJEHRRRA E RAMIZËZ

(Ranicë, Preshevë)

Oj vjehrra e Ramizës, fustanin me lule,

E bitise darsmën me kaçika pule,

Oj vjehrra e Ramizës, fustanin me vija,

E morët Lulijen hiç pa çallgija...

Në mesin e dhomës vjehrra, kunatat e krushkat tjera i falin nuses edhe peshqeshe të ndryshme. Natyrisht të gjitha këto ceremoni përcillen edhe me këngë. Ashtu nusja si ka hyrë edhe del me një delikatesë të madhe duke bërë edhe temena, madje nusja del te mbrapa, pra në shenjë respekti, nusja asnjëherë nuk ua kthen shpinën vjehrrës dhe krushkave.

Menjëherë shtrohet dreka për krushkat. Zakonisht dreka është e mirë, siç thonë këtu “Prej çorbës e deri në bakllavë. Pasi krushkat t'i lajnë duart shtrohet sofrabezi dhe sofrë. Pavarësisht sa krushkat vijnë, shtrohet vetëm një sofër. Pra, edhe këtu fillohet me çorbë e vazhdon... Edhe derisa hanë drekë, shoqet e nuses vazhdimisht duke kënduar i ngacmojnë krushkat, mirëpo shpesh ndodhë që edhe krushkat ua kthejnë me alegori e ironi të qëlluara:

ORI GRA SHKA PO KSHYRNI PËRPJETË

(Tërrnavë, Preshevë)

Ori gra shka po kshyrni përperjetë

a s'keni pa kurrë pite me petë

Krushkat përgjigjen:
Kemi pa e kemi hongër promë

Pites juve po i vjen era tërshonë

Si me pas gatu me komë.

Këto këngë, informaret thonë, se nuk janë autoktone, por na kanë ardhur nga Kosova, domethënë. i kanë lexuar nëpër libra dhe në revistën "Jeta e re".

Nganjëherë shkojnë shumë krushka e s'i zë sofa:

Ani këto krushkat kokan shumë ngushtë,

Se i lojnë lugët edhe hajnë me grusht...

Ani mori krushka kokshni shumë të mira,
I pasni dhomtë për me nxjerrë kompira...

Pastaj, vajzat këdojnë se mjaft keni ngrënë:
Rrag- dang -dang po bon legeni.
Çonu ma ju hiftë veremi...Dang- dang-dang po bon tepsia

Çonu gra ju hiftë tërpia...

Kështu vazhdon derisa të shtrohet bakllavaja. Tash përsëri hyn nusja. Njëra prej grave e merr pak bakllavë dhe ia kërkon nuses, sigurisht që nusja të bëhet gojëmbël. Nusja del prej dhomës.

Tashmë, nusja dhe fillon t'i marrë ngryk e të vajtojë, dmth. nusja hallashtiset, sepse vërtet më po ndahet prej shtëpisë dhe të afërmeve të saj.

Tash gjithë punët i marrin gratë e shtëpisë së nuses, ndërsa krushkat heshtin dhe vetëm i përcjellin se si po veprojnë gratë e nuses.

Në oborr s'ka asnjë mashkull.

Deri sa gratë veprojnë sipas dokeve të tyre edhe në konakun e burrave zhvillohet muhabeti . Në fillim burrat shërbehen me cigare dhe djemtë, që shërbejnë ua ndezin cigaret. Secili krushk hyzmetçiut ua ofrojnë nga një pako me cigare e ata ua shpërndajë njerëzve të shtëpisë, duke u treguar cigaren e ki prej filanit. Këtu zhvillohen edhe bisedat e rrafshëta. Nëse krushqit kanë ardhur me muzikantë, atëherë hidhen edhe disa valle. Zakonisht luajnë valltarë të përzier, pra si të nuses,

ashtu edhe të dhëndrit. Këtu luajnë valle të matura. Vallen e hedhin herë lojtarët e shtëpisë e herë krushqit. Derisa gratë thumbohen me fjalë, te burrat sjellja dhe mikpritja janë në nivel. Pra, priten dhe përcillen me respekt.

Pas muhabetit, gjegjësisht valleve hanë edhe drekë. Edhe kjo drekë është përgatitur shumë mirë. Me krushqit, në sofër, ulet edhe ndonjë nga burrat e anës së nuses. Këta më tepër kujdesen që krushqit të ndahen të kënaqur. Pas drekës, burrat bisedojnë, por janë gati që, kur të bëhen gratë gati edhe këta të dalin.

Gratë ngritën dhe hipin nëpër qerre pa kurrfarë zhurme. Pastaj vijnë meshkujt e shtëpisë së nuses. Ata i bien qetë apo kuajt dhe i bëjnë gati qerret. Nusja s'pushon së qari. Ndahet nga të afërmit e saj. Qan dhe dënesë kur ndahet nga vëllezërit, motrat, prindërit etj. Të gjithë i merr ngryk. Gati qajnë të gjithë. Dhembje e madhe. Shpesh qajnë edhe krushkat. Në fund hip nusja në qerren e parë. Pasi të rehatohen krushkat, qerret dalin nën kujdesin e burrave të vajzës. Edhe këtu rrotave të qerres së nuses u qitet ujë. Kur niset qerrja një djalë i lumtur nga familja e vajzës e thërret nusen 3 herë në emër. Kjo thirrje bëhet me qëllim që nusja të lindë djalë. Tash para qerreve janë edhe kuajt të ngarkuar me pajën e vajzës. Kuajt për freri i mbajë njerëzit e nuses. Zakonisht janë dy kuaj apo 2 seksone të mbuluara me qilima. Ende qerret janë në kujdesin e meshkujve të shtëpisë së nuses. Kur dalin në rrugë ndalen qerret dhe lajmërohen krushqit që dalin nga konaku. Kur afrohen krushqit te qerret, përfaqësuesi i familjes së nuses ia bën **teslim** përfaqësuesit të krushqve dhe ia dorëzon qerren me nuse. Me rasti e pranim-dorëzimit të qerreve, pos tjerash, përfaqësuesi i nuses i thotë edhe disa fjalë: **“Gjaku osht i joni a namuzi (nderi) i juve”**, domethënë se nëse nusen e vret ndokush atëherë gjakun e nxjerrin familja e nuses, ndërsa në rast se dikush e cenon nderin e nuses, atëherë për të kujdesen dhëndëri dhe familja e tij. Krushqit e pranojnë qerren edhe djemtë afrohen te seksonet, i marrin tash ata. pas kësaj ceremonie kërcasin pushkët dhe fillojnë vajzat dhe krushkat të këndojnë.

Gjatë daljes së grave, krushkat, si tinëz, marrin edhe ndonjë gotë, bile vetë ua japin gratë e shtëpisë së vajzës.

PLAS XHYSHE PLAS

(Kurbali, Preshevë)

Plas xhyshe plas,
Pi ujë me tas,

Lulën e morëm,

Therrë jav lamë,
Lulen e morëm me lulue ,

Therrën jav lamë me ju therrue.

Gjatë këndimit të kësaj kënge dhe këngëve të tjera, krushkat dhe defatolet e kallin atmosferën. Zakonisht në qerre këndohen këngë të gëzueshme, ndërsa aty-këtu mund të ketë edhe vargje shpotitëse, por gjithnjë duke e lavdëruar dhëndrin, njerëzit, që janë me qerre, dhe familjen e tij.

HYNI DRITA PËR DALLAPI (Rahovicë, Preshevë)

**Hyni Drita për dallapi,
hajde lulë, a je ba gati?
- Jam ba gati, jam bitisë,**

pi pres trimat për m'u nisë.
- Trimi ma i pari, trimi ma i miri,

**Ismet aga, gojë bylbyli,
gojë bylbyli, mintan shkruemi,**

Femi aga gojë praruemi.
- Kadal lule, mos ngut kerrin,
po e shkel Femi dylberin!
- Do ta shkeli, ta baj drrasë,

se mu zemrën ma ka plasë.

Ma ka plasë, ma ka ndryshkue,
larg pi nonës, m'ka largue,

e ngat vjehrrës m'ka afrue.

KA DALË LULA JONË

(Rahovicë, Preshevë)
Ka dal lulja jonë në ni kodër-o,

ka dalë në ni kodër e po vete-o:
- Sa koshiçe i keni me blete-o?
- Lule, nizet e xhashtë, nizet e shtatë,
ani kurr s'e hajmë bukën thatë-o,

ani ja me djathë, ja me mjaltë-o.

Siç kemi cekur edhe më parë, nëpërmjet këngëve, dhëndri dhe njerëzit e familjes, ngrihen në qiell, duke ua mbathur të gjitha të mirat.

Krushqit me nuse vazhdojnë rrugën, bile diku edhe e thyejnë (ndërrojnë) rrugën. Kjo ka mbetur prej kohësh, që mos të bien diku në pritë.



Aty kah gjysma e rrugës, vjen një djalë i ri dhe e merr **jastëkin** që e ka bërë gati nusja për dhëndrin. Djali duke vrapuar fshehurazi arrinë deri te dhëndëri. Ardhja e jastëkut është një paralajmërim se nusja është duke ardhur. Dhëndri e merr jastëkun dhe djalit i jep të holla. Në jastëk ka qenë edhe ndonjë peshqir, apo çorape prej nuses që i takon djalit që e solli atë.

Pasi ardhja e jastëkut paralajmëron ardhjen e qerreve, atëherë edhe dhëndri e shumë të tjerë dalin për t'i pritur krushqit në vendin e duhur, sepse çdo fshat e kanë një vend të caktuar. Çdo nuse i ka bërë gati disa gjëra për gara vrapimi, si çorape, peshqir, këmishë etj. Pra bëhen garat e vrapimit së pari fëmijët, pastaj pak më të rriturit e në fund edhe burrat. Ndodh që garojnë (vrapojnë) edhe me kuaj. Në

ndonjë dasmë të ndonjë të pasuri, i zoti i dasmës paralajmëron edhe fshatrat për rreth, se për fituesin do të ketë edhe dhuratë të mirë si dash, lopë etj. Kështu që herët pronarët e kuajve bëhen gati, pra i stërvisin për gara. Pas vrapimeve të njerëzve vjen vrapimi kryesor, domethënë. me kuaj. Që më parë është caktuar nisja dhe fundi i vrapimit. Fundit të vrapimit, rrugës i thoshin **allaj**, pra cili kalë hy i pari në allaj, ai edhe del fitues. Këtu mora edhe disa të dhëna interesante nga mësuesi **Demush Ahmeti** (tash i ndjerë), nga fshati **Sefer**, i lindur më 1939 . Pasi rruga e vrapimit mund të jetë e gjatë dhe e lodhshme, kuajt lodhen para allaj-it, atëherë kalorësit mund të zbresin nga kuajt dhe të vrapojnë vetë binxhijtë dhe cili binxhi hy i pari në allaj, ai shpallet edhe fitues. Mësuesi Demush na tha edhe një gjë interesante. Se ka pasur raste, kur një kalorës rrëzohet nga kali, por kali vrapon vetë dhe hy i pari në allaj edhe ai konsiderohej fitues.

Vrapuesit dhe kuajt i përcjell muzika apostafat për ta me një ritëm të caktuar, sidomos në finish. Vlen të ceket dashi, që është caktuar për dhuratë, zakonisht është shumë i pashëm. Atë e krehin mirë në brirë i vënë mollë me rruaza etj...

Në lidhje me garën e kuajve, Demush R. Berisha (1938) na foli edhe për një gjë mjaft karakteristike. Kur u martua, vetë Demushi, në vitin 1957, patën dasmë të madhe e me shumë miq, sepse ishin “shpi e madhe” dhe e dëgjuar. Ata, më herët, e kishin përhapur lajmin se në dasmën e tij do të ketë gara me kuaj dhe si shpërblim fituesi do ta marrë një dash. Kështu, kalorësit (binxhijtë) me kuaj kishin filluar ushtrimet herët. Në ditën e garave, kuptohet dita e ardhjes së nuses, pas vrapimit të fëmijëve e të rinjve, u erdhi radha e vrapimit të kuajve. Në këtë garë, garuan shumë kuaj, ku mori pjesë edhe **kali i Riza Berishës** me kalorësin **Agush R. Berisha**. Pra edhe kali edhe “binxhiu” ishin të zotit të dasmës. Për çudi, gjatë vrapimit në cak (allaj), i pari mbërriti kali i të zotit të dasmës. Mirëpo, pasi edhe kalorësi ishte i kësaj shtëpie, atëherë Riza Berisha (Buhici), dashin ia dha kalit dhe kalorësit, që erdhi i dyti, Rashi Sylejmanit të Caravajkës. Fjalët e Demush Berishës, i vërtetuan edhe disa të tjerë.

Pasi kryhet vrapimi, vazhdon ceremonia e dasmës. Hyn qerrja me nusen. Defatoret gati i shqyen defet, kënga jehon në të gjitha anët. Nga qerrja zbresin të gjitha gratë. Krushkat këndojnë e kërcëjnë duke i reklamuar gotat e sendet tjera që i kanë marrë nga shtëpia e nuses. Erdhi rasti që edhe **Nusja** të zbresë . Dy gra e afrojnë pranë bigës së qerres, ku e pret vjehrrin. Kur mungon vjehrrin, vjen mixha, apo kunati i madh. Nusja, në shenjë respekti, vjehrrit i fal ndonjë garniturë të punuar me dorë apo edhe ndonjë jamboli. Nganjëherë vjehrrin nusen e merr në krahë e më së shpeshti e kap për krah. Ata ecin ngadalë dhe janë shumë të qetë. Gjatë gjithë kësaj ceremonie vajzat e përcjellin me këngë.



Krushqit, duke u bërë gati në vitet e 70 për të marrë nuse në Preshevë



Tërrnoc para Luftë së Dytë Botërore

Vajzat këndojnë:

HYNI KERRI N'DYERT E MDHAJA
(Preshevë)

Hyni kerri n'dyert e mdhaja,
në shpi tonë a ardhë dynjaja;
erdh dynjaja për me pa
nusen tonë, bajrak nër gra.

Ej allah-o, ej allah,
t'tana bani Mashalla,
mashalla e lum e lum!

Do ta kallim ni katun.

Mashallah po knojmë me mall,
do ta kallim ni mahallë.
Mashallah po knojmë pa hile,
do ta kallim ni kabile.

LUMËT NA TË LUMËT, DUL BAJRAK NDËR GRA
(Rahovicë, Preshevë)

Po vjen nusja jonë rrethit malit-o,
përpara shkojnë krushqit në vithe t'kalit- o.

Ani në vithe të kalit tue lodrue,
lumët na të lumët, nusen sot kem prue.

Kemi prue nusen me krushq e bajrak,
sa ma shpejt të ja hjekim na, more qat duvak.

Ani qat duvak ma shpejt për me pa,

lumët na të lumët duel bajrak ndër gra.

Informatorja Zejnepe Shabani, bijë nga Norça e martuar në Maqedoni, lindur më 1933 thotë se kënga “Lumët na lumët...” është kënduar, kur ka qenë kjo fëmijë, atëherë kur nuset i merrnin me kali.

S'NA KA LYP LULIJA LIRA

S'na ka lyp Lulija lira jo moj jo,

S'na ka lyp Lulija lira jo moj jo,

Na ka lyp djalin tone po mor po,

E ka lyp e ka gjet po moj po,

djalin e mire me fakultet, po moj po.

S'na ka lyp Lulija hallka jo moj jo

S'na ka lyp Lulija hallka jo moj jo

E ka lyp djalin me franga po moj po.

E ka lyp e ka gjet po moj po,

djalin e mir gjentellmen po moj po.

ARUSHA BUTË
(Leran, Preshevë)

Oj arusha butë, oj arusha butë.
Hec ma kadale hiç mos u tut.
Oj arusha butë, oj arusha butë,
Çitja vjehrrit krahin hiç mos u tut.
Zhdrypne moj zhdrypne prej kerrit,
Për inati të çatij babxhysh derrit,
Zhdrypne, mori zhdrypne prej trinës,
Për inati të çasaj xhyshe shkinës.
Kshyrni çika, shyrni gra,
Çesi nuse s'keni pa...

ANI, MËRI ANI, NA TA KALLMI
(Tërnavë, Preshevë)

Ani, mëri ani, na ta kallmi,
ani shkado nuse na nuk marrim,
ani shkado nuse besharet,
po shkojmë besa, edhe e zgjedhim vet.

Ani, mëri ani, se na shkoi kjo ditë,
t'lumtë na, t'lumt-o, kët e kena pritë!
Hani, mëri hani, se na shkoi kjo natë,
t'lumtë na, tlumt-o, po marrim kunatë!

BUJRUM, NUSE, BUKË E DJATH
(Lesbali, Preshevë)

Byjrum, nuse, bukë e djath-

na ka lypë lirë edhe vathë.

Byjrum, nuse, bukë e krypë -

na ke lypë sahat e rryp.

Byjrum, nuse, bukën thatë-

ke lypë rena me dukatë.

Ke me u tha e ke me u terë,

s'na la miku gja n'kit derë,

pika e tamlit s'a për verë.

S'ke me ditë se cka a maza -

na i ke lypë nja tetë unaza.

Lula jonë, o mori dritë,

lugët n'pod na i kini qitë.

Ka pasur raste kur familja e nuses ka kërkuar që nuses t'i blejnë orë, vathë, dukat, unaza etj. Kështu që vajzat me anë të këngës ia përmendin nuses, si p. sh. në këngën “Bujrum nuse bukë e djath”. Në këngë thuhet se tash duhet të hamë bukë e djathë, bukë thatë etj.

Mësuesi Demush Ahmeti, njohës i mirë i jetës në Karadak të Preshevës, na thotë shumë bindës, se në Malësi ka ndodhur që ndonjë prind i vajzës, prej familjes së dhëndrit, ka marrë edhe para, pra e ka shitur vajzën. Pasi ka qenë vajza e bukur, familja e burrit s'është kursyer. Kjo ka ndodhur më së shpeshti, kur dhëndri ka qenë me të meta, apo kur dikush e ka marrë gruan e dytë. Ndonjë rast ka pasur edhe në fshatra dhe qytet.

Zakonisht kur kanë marrë nuse për qejfi edhe këngët disi janë thurur e kënduar më bukur. P.sh. në fshatin Corroticë është shënuar një këngë e tillë, ku asaj familjeje i buzëqeshë fati dhe zakonisht marrin nuse të mira, ku janë të kënaqur e tërë familja. (Në oborr tonë)

NË OBORR TONË (Corroticë, Preshevë)

Në oborr tonë ka bi bari,
nuse të mira po na sjell zari,

moj na sjell zari e shtëpia,
lum kunata e lum vjehrria.
Lum vjehrria e merr për djale.
Lum kunata që e merr për vlla.

O LUMËT NA
(Preshevë)

O lumja toka o që e shkel me komë,
O lumja vjerra, kush e thirr oj nonë,
O lumja toka o që e shkel me kamë,
O lumi vjerri, kush e thirr o babë.

NAFAK TË MADHE KISH PASË KY QELI
(Rahovicë, Preshevë)

Jetimo jom kon-o, jetime jom rritë,
për dy grosh mixha mue më ka shitë,
te ni hashan mue më ka fejue.

Erdh hashani me më marrë mue,
dyfish në kali më ka ngarkue,
prej inatit unë jom shtremnue,
zhag për toke floktë m'kanë shkue.

Më shtinën n'oborr të hashanit të ti,
me ni sobë mue më kanë shti.

Rend me rend u mbush oborri:
vishin cikat mem pa mu',
njona në tjetrën n'mue bojnë seri:

nafakë të madhe kish pasë ky qeli!

Shkojshin çikat vishin nuset,

nëpërmjet veti bojshin seri:

nafakë të madhe paska pasë njeri!

Shkojshin nusët vishin plakat,
hynën plakat me bo seri:
nafakë të madhe paska pasë i mjeri!

Kur hyni hashani i zi,

as s'më kqyrke mue me sy!

Shumë i keq dreçi ish konën,

kish pasë mustaqet anë m'onë!
Ka niherë e kshyrsha me sy,

me veti i thojsha, tybe s'trri!

Tue u da nata, tue u da dita,

ika hashan, ty të korita.
Për këtë faj, qi po e boj,
mixhës tem ti shko kallxoj!

Se me ty unë s'rrnoj,

drejt te shpija unë do të shkoj.

Në këtë këngë flitet për një martesë, ku mixha e marton mbesën për një burrë, që nuk është i nivelit të vajzës, bile thuhet se mixha mbesën e ka shitur. Burri si nga pamja e jashtme, ashtu edhe nga mendja është prapa, siç thotë populli “si me hije e si me fije” s’i plotëson kriteret e një burri. Kjo këngë edhe pse është shënuar në Rahovicë të Preshevës, nuk është e vendore, por rrënjë i ka diku tjetër.

Në këtë rast nusja i fal vjehrrit ndonjë batani, këmishë apo diç tjetër. Nusen e ndalin në ndonjë vend që të shihej më mirë. Aty edhe ia heqin duvakun dhe shtien me pushkë. Të gjithë shikojnë, këndojnë e duartrokasin. Diku në ndonjë skaj është

edhe dhëndri. Ai përciptazi shikon nusen. Edhe nuses ia bëjnë me dije se kah është dhëndri e kjo, vjedhurazi, e shikon nganjëherë, sepse nusja vazhdimisht sytë i ka të mbyllur. Nëse nusja s'është shumë e madhe vajzat këndojnë:

OJ LULIJE, HE ZAMBAK

(Bukuroc, Preshevë)

Oj lulije, he zambak,

Pse s'u rrite edhe pak,

Edhe pak mu pas rritë,

Bojshe dritë si aletrik...

Pra, posa të zbresë nusja pre qerres ua marrin tre djemve kapuçat (kapelat) që të ulet nusja mbi to. Ky rit bëhet që nusja të lindë fëmijë meshkuj. Pra, siç po shihet, si në të gjitha trevat shqiptare edhe në trevën tonë, vlerë më të madhe kanë fëmijët meshkuj.

Si deri më tash edhe më vonë vajzat vetëm këndojnë:

KALLNE, KALLNE, CITJA FLAKËN

(Rahovicë, Preshevë)

Kallne , kallne, çitja flakën,

Po e martojmë Agim agën,

Kallne, kallne, çitja timin ,

Po e martojmë Agim trimin.

Vajzat këndojnë edhe këngë kundër familjes së nuses e konkretisht kundër babait. Ato babanë e nuses e quajnë derr dhe me sjelljet e tij, na del si mashkull i dobët, madje ai na paraqitet si njeri jo i fjalës. Ai edhe pse thotë se nuk do ta përcjellë vajzën, por më vonë i ndërron fjalët. Si p. sh.

KUR HYPE NË KERR OJ NUSE

(Rahovicë, Preshevë)

Kur hype në kerr oj nuse shka kshyre temas,
U tuta po ma vjedh baba çejzin e po m'bon Zoti gaz.
Po m'bon Zoti gaz e po m' korit,
Po ma çon n'pazar për me shitë.
Vazhdojnë edhe më:
Be e bee babxhysh derri tha s'e jap sivjet,
Kur ju sos he buka derrit erdh na luti vetë,
Erdh na luti vetë o dilinxhija,
ja kishim marë grujën porezxhija.

Ato s'e lënë keq edhe nënën e nuses :

Deri ku të përçull oj nuse nona,
Ani deri te vija o rrëspija,
Kthev oj none kthev mos kije dert,
Kthev e bjeri dahires çysh e ki adet.
Tash vajzat dëshirojnë që ta paraqesin dhëndrin si burrë të ashpër, gjë që e vërehet
në vargjet:

Ore Amet aga e vetull drapën,
Po thotë lulija konke xharpën,
Ani nuk jam xharpën për me t'ngronë,

Ani jam çaj Ameti shka t'kam thonë.
Kështu dikur edhe kënga ndalet, disa gra pushojnë, bile pushon edhe nusja.
Në fshatin Norçë e dëgjuam dhe e shënuam edhe këtë këngë:

Oj lulije, he llokum ,
Llokumi me arra,

**Sa ka nuse në Preshevë.
Ti je ma e para,**

**Oj lulije, he llokum,
Llokumi me ngjyra,
Sa ka nuse në Preshevë,
Ti je më e mira.**

(E këndoi dhe e shënoi Hyrije Ibishi-Emini, dëgjoi në Kosovë)

Dikur nusen e shpien në dhomë për të pushuar. Pastaj vajzat dhe nusja fillojnë ta shtrijnë çejzin (pajën). Më herët çejzin e shtrinin nëpër muret e dhomës, ndërsa më vonë, për mos t'i shkarravitur muret, pajën e vendosnin në dysHEME, mbi kanape etj.

Nata e hoxhës, duaja, dhëndri hyn në gjerdek

Kjo natë është kryesisht të dielën apo të enjten në mbrëmje. Atë natë ftohen vetëm më të moshuarit të familjes, pra pak si më fetarë, dhe të miqësisë së mëhershme, ku fjalën kryesore e ka hoxha. Pasi hahet darka, ftohet dhëndri në dhomë. Dhëndri ulet në gjunjë para hoxhës, hoxha i bën dhëndrit duanë. Më herët duaja bëhej vetë në gjuhën arabe, pra s'e kupton askush e tash e bëjnë edhe në gjuhën shqipe. Pas duasë së hoxhës, shokë dhe të afërmit e djalit e përcjellin dhëndrin në dhomën e gjumit (në gjerdek) te nusja. Para se të hyjë në dhomën ku e pret nusja e shoqëruar nga motrat e djalit apo edhe dy gratë të afërme të familjes, dhëndri duhet të thyejë një filxhan në pragun e derës. Moshatarët e godasin në shpinë dhe ai turr e vrap duke i ikur goditjeve të tyre, futet në dhomë. Pasi njihet me nusen, motrat a gratë që gjenden brenda dalin duke i lënë të vetëm të dy të rinjtë. Të tubuarit, që përcjellin dhëndrin në gjerdek, vazhdojnë këngën e vallen në korridor edhe për një orë, e më pas shpërndahen. Nëna e djalit qëndron te dera e dhomës dhe dëgjon çfarë bëhet brenda. Pasi të mos dëgjojë më zëra, shkon në dhomën e vet të fjetjes. Te ne ka ndodhur, që dhëndri duke thyer filxhanin, e ka lënduar shumë këmbën, sa që e kanë dërguar edhe te mjeku.

**KUSH ASHT QAJ NË KAPIXHIK?
(Rahovicë, Preshevë)**

Kush asht qaj në kapixhik?

Jusuf aga si zabit.

Dil, moj nuse, n'dash m'e pa,

si bylbylin për hava.

Ka dalë nusja n'derë të madhe.
Jusuf aga po ngre' valle;
po ngre' valle me shokë t'tij.

Po e kshyr nusja me sy,
po e kshyr, buza n'gaz po i shkon

hem çiknijën po e kujton.

PO VJEN VJEHRRA, TAK, TE DERA
(Rahovicë, Preshevë)

Po vjen vjehrra, tak te dera:

- Hajde, oj bi, se u ba dreka!

- Hajt, oj nanë, ti mili lop't,

se unë jam tuj i krehë flock't.

Po vjen vjehrra, tak, te dera:

- Hajde, oj bi, se u ba dreka!

- Hajt, oj nanë, lishoi pelat,

se unë jam tu' i krehë kucelat.

Po vjen vjehrra, tak, te dera:

- Cycja unë, ce tri hera,
Hajde, oj nanë, lishoi pulat,

se unë jam tuj i 'ndu lulat.

Simotra e kësaj kënge është shënuar edhe në fshatin Leran të Preshevës.

Kulaçi i Nuses

Pas kalimit të natës së dhëndërisë, djali del nga dhoma dhe pasi të jetë dëshmuar morali dhe virgjëria e nuses, atëherë ftohen familjarët e dhëndrit, xhaxhallarët, dajallarët dhe dashamirët e miqtë e familjes për të ngrënë “petullat.

Gratë e shtëpisë, posa marrin vesh virgjërinë e nuses, herët në mëngjes fillojnë përgatitjet për bërjen e petullave.

Shpesh, virgjërinë e nuses, të familjes, e shënojnë ,duke shtënë me armë.

Për ndarjen e kulaçit, zakonisht mbledhen vajzat dhe djemtë të pamartuar. Në kulaçin e gatuar më parë shtihet edhe një monedhë metali. Këtu vajzat dhe djemtë merren vesh se kujt do t'i qëllojë monedha me çka do të shpërblehet. Shpërblimin e jep nusja, gjegjësisht dhëndri. Gjatë kësaj ceremonie kulaçin e bien vajzat në mes të dhomës, ku afrohen edhe djemtë. Kulaçin, rëndomë e sjellin nëpër duar për ta hequr dyshimin se mos ka ndonjë hile. Pastaj, secili merr nga një pjesë të kulaçit. Ai ose ajo që e gjen monedhën gëzohet dhe e tregon monedhën. Të gjithë të pranishmit ia urojnë. Atëherë nusja, gjegjësisht dhëndri ia, fatbardhit ia jep shpërblimin e duhur. (kështu na informoi 70 vjeçari Xh. Rexhepi.) Pra mbaroi edhe ceremonia e ndarjes së kulaçit.



Është zakon që të hënën nusja vishet me dimi.

Tash jemi në kohë kur njerëzit vijnë të hanë petulla. Të ftuarit në dhomë i pret nusja e palosur, e cila pastaj një nga një ua merr dorën të pranishmëve në dhomë. Aty janë gra dhe burra.

Më herët luheshin edhe dy-tri valle të qeta, bile një valle e udhëheq dhëndri.

Pas ngrënies së petullave, të gjithë të pranishmit do t'i dhurojnë nuses bakshishe të ndryshme, para, stoli ari, unaza, byzylykë, por më së shumti i lënë para. Vlera e peshqesheve varet nga afërsia e të pranishmëve me të zotin e shtëpisë dhe djalin. Pastaj, të pranishmit pasi të kryhet ky rit do të dalin nga dhoma për t'u liruar vendin grave për përgatitjet e mëtutjeshme. Në shenjë respekti nusja të pranishmëve u fal çorape ndonjë peshqir etj., ndërsa vjehrrit kunetërve u jep këmisha e diç tjetër.

Para shumë vjetësh, bijat, ndonjë hallë apo kunatë kanë hyrë në dhomë "kryeshtrume", pra pa shamia, atëherë nusja në krye u ka lidhur shamia. Sot nusja të gjitha grave të pranishme u jep përparëse, çorape e grave të moshuara u falë "namazbeza".

Pas ceremonisë së petullave, në një mënyrë pushon dasma. Të gjithë pushojnë. Pushon edhe nusja, madje edhe fle. Pushojnë, sepse pas dreke, përsëri mbushet shtëpia me gra e vajza

Duhet të ceket se pajën, që e ka sjellë nusja, vajzat dhe gratë e kanë shtrirë në dhomë, pasi edhe në shtëpinë e burrit vijnë gratë për ta parë.

Këtë ditë, po edhe ditëve të tjera, njerëzit shtëpisë, e porosisin nusen se si t'u drejtohet personave të familjes. Kështu, kunatit të madh – byjyk aga, kunatit të vogël – kyçyk aga, dikujt tjetër – syvgjyl aga e të tjerëve në emër, po duke ia shtuar edhe epitelin AGA, si p.sh. Qemal aga, Ali aga, Vebi aga...etj. E njëjta gjë bëhet edhe me botën femërore. Kështu kunatat etj. i thirr: byjyk hanme, birinxhi hanme, syvgjyl hanme, kyçyk hanme, emshire hanme, kimete hanme, jalldëz hanme, hanëm ingje, hanëm aba, syvgjyl aba, bir etj. Siç po shihet të gjitha këto thirrje, janë turqizma, që në fillim, më tepër janë përdorur në qytet e dikur edhe në fshatra.

Te ne edhe sot e kësaj dite njerëzve më të moçëm u drejtohem me AGA, si aga Agim, aga Durak, aga Sami etj. Pra, fjalën agë e përdorim në shenjë respekti në vend të fjalë BAC.

Të hënën, gjegjësisht të premtën pasdreke, vijnë gra e vajza nga tërë fshati. Ato enkas vijnë për ta parë pajën (çejzin) dhe nusen. Nusen e veshin me rrobat më të mira. Thashë edhe më herët se interesimi për pajën është i madh. Vajzat çdo pjesë të pajës e studiojnë mirë e mirë, e më vonë t'i punojnë edhe vetë. Kështu paja në dhomë rri e shtruar një javë, apo deri sa të shkojnë dhëndër.

Familja e dhëndrit, duke e ditur se nusja në fillim edhe mërzhitet për familje, pas 3-4

ditësh vjehërria së bashku me nusen shkojnë, për disa orë, në shtëpinë e nuses. Pas pak kthehen.

MARRJA E NUSES NË RRUGË

Ka pasur raste , kur familja e dhëndrit dhe familja e nuses kanë qenë shumë larg njëra- tjetrës. Në këso raste, njerëzit e kanë menduar një gjë të re, kështu që, familjet në fjalë, janë marrë vesh që familja e nuses ta afrojnë nusen diku në mes të rrugës. Pra, deri sa krushqit me qerret e nuses nisen me të gjitha ceremonitë duhura, nga ana tjetër, në mënyrë shumë modeste, njerëzit e familjes së nuses e marrin ashtu të veshur e hipin në kal, apo në qerre dhe nisen për në vendi e caktuar. Ndarja e nuses prej familjes është rëndë. Edhe këtu nusja “hallashtiset” me anëtarët e familjes duke qarë e duke dënesur. Zakonisht në vendin e caktuar , të parët mbërrijnë të nuses. Ata ndalen dhe presin deri sa të mbërrijnë pala tjetër. Kurt ë takohen të dy palët, përshëdeten në mes tyre. Nëse është moti i mire, ulen, ndrojnë cigarette. Ndërkohë, ndonjë burrë dhe disa gra e marrin nusen dhe e fisin në qerre. Në raste të tilla, me qerre, vijnë 3-4 krushka. Edhe këtu bëhet pranim-dorëzimi sikur të ishim në shtëpinë nuses. Pas “teslimit” shtihet edhe me pushkë. Pastaj, njerëzit e nuses kthehen në shtëpi e qerrja me nuse vazhdon për në shtëpinë e burrit. Çdo gjë vazhdon si në dasmat e zakonshme. (Këto të dhëna i morëm prej mësuesit 80 vjeçar Demush R. Berisha)

VIRGJËRIA E NUSES

Tash do të përpiqemi që me disa fjalë ta shënojmë edhe rastin, kur vajza, që vjen nuse nuk është e virgjër, apo siç thuhet te ne, kur nusja “nuk del çikë”. Kështu kur hy djali dhëndër, pasi mbetet vetë me nusen, bien në shtrat... Kur e vëren dhëndri se nusja s’është e virgjër fillon ta rrahë ta torturojë nusen me qëllim që ajo ta pranojë se kush është ai mashkull, që e ka zhvirgjëruar. Dikur ajo e tregon edhe atë person. Gati 90% është incest, dmth, se është zhvirgjëruar nga anëtarët e familjes, (kushëri, dajë, djalë teze etj). Kështu marrin vesh familja e djalit dhe gjithë gëzimi shndërrohet në vaj. Nusen e torturojnë shumë. Në fshatin Rahovicë, ka ndodhur që dhëndri ia ka prerë edhe gërshetin dhe e ka varur në tra të dhomës. Më herët gati çdo gruajë të tillë ia kanë prerë flokët, pra e kanë bërë me shenjë, madje në trevën tonë, dëgjohet prej grave, edhe shprehja përbuzëse “Flokë rume” . Për vajzat që “lishohen at’ natë” (populli e ka edhe shprehjen “kjo osht lishue at’

natë”) gjë më të keqe nuk ka, pra është më e rëndë se vdekja, sepse kjo ta merr fytyrën.

Menjëherë, kur del dhëndri prej dhome, duhet të lajmërohen familja e vajzës. Zakonisht njëherë lajmërojnë te mixha, apo te daja i vajzës. Këtu fillon tmerri. Shpesh ka ndodhur që familja s’e ka pranuar vajzën në shtëpi, po e kanë martuar, po atë natë për ndonjë plak apo për ndonjë person të shëmtuar, madje edhe me të meta mendore. Ka ndodhur që dikush e ka marrë si grua të dytë, për të lindur fëmijë. Çdo burri, familja e vajzës, i kanë thënë që “t’ia shtypin krytë”, dmth. Vazhdimisht ta torturojnë. Gratë e tilla edhe në familjen e babës shkojnë rrallë dhe gjithmonë janë të përbuzura prej çdokujt, madje edhe nëna e saj heq të zitë e ullirit, sepse edhe asaj i hidhet faji, pse s’është kujdesur sa duhet për vajzën. Me një fjalë e tërë familjes i ka rënë një hije e zezë, bile edhe të afërme të tyre.

Tash do të shkruaj edhe për ngjarje tjetër që ndoshta s’është e vetme. Edhe kjo ka ndodhur në fshatin Rahovicë. Vajza, që ka shkuar nuse, sipas dhëndrit s’ka dalë e virgjër dhe kanë lëshuar. Vajza kurrësi nuk e pranon fajësinë dhe thotë se është e pastër. Ajo nuk pranon as të martohet më, por sëmuret dhe vdes. Të gjithë i besojnë vajzës dhe tash janë të bindur se kjo është bërë për gabime biologjike. (temë e mirë për shkrimtarët)

Informatori Abdyrrahman Haliti , tash i vdekur, ka pohuar se në Preshevë, ka pasur raste që si ju ka lëshuar vajza, më deri sa ka vdekur, s’ka dalë në pazar.

Që mos të vijë deri te “i lëshimit at’ natë”, vajza prindërit i ka sinjalizuar më parë, kështu vajzat e tilla i kanë martuar duke u treguar familjes së burrit, se nëse e pranojnë në këtë gjendje, pra e martojnë “me fjalë”. Zakonisht në raste të tilla thonë se vajza e tyre, kur ka qenë e vogël është rrëzuar apo diç tjetër, pra disi e zbusin pak.

Thamë edhe më herët se pjesa dërmuese e zhvirgjërimit ka ardhur nga incesti. Thuhet se një rast ka ndodhur në një fshat të Preshevës. (emrin s’po e shënoj me qëllim) Prindërit kanë kuptuar se vajza e tyre diç s’është në rregull. Kështu që babai i vajzës, duke e pastruar pushkën “pa hiri” e qëllon vajzën me plumb dhe e vret në vend. Kështu vajza vdiq dhe varroset.

Kur ndonjë vajzë “e ka hup çikninë” me ndonjë person që “i bje me marë”, atëherë familja e vajzës ia çojnë personit vajzën në shtëpi dhe i thonë “merre se ti e ke bo për veti se s’ka metë për tjetër kon”. Ka ndodhur që ia kanë çuar edhe burrit, që ka qenë i martuar, dmth. ai i ka bërë dy gra.

K r e u VIII

CEREMONIA E SHKUARJES SË DHËNDËRIT

Pas disa ditësh duhet të shkojë dhëndri me ca shokë te familja e nuses, me qëllim që të njihet dhëndri me anëtarët e familjes së vajzës. Për këtë rast familja e vajzës përgatit një drekë shumë të pasur.

Në shtëpinë e dhëndrit bëhen gati. Të gjithë janë të rinj, pos njërit që duhet të jetë më i moçëm. Edhe pse të gjithë vishen mirë, po gjithmonë vëmendjen ua kushtojnë dhëndrit. Atë disi e kanë si violinë të parë. Kur kanë shkuar me kuaj, kali i dhëndrit është dalluar për të mirë. Të gjithë sytë i kanë tek ai. Ashtu të gëzuar nisen. Sigurisht , të familjes dhëndrin e mësojnë, që të ruhet e të mos bjerë në ndonjë grackë. Rruga kalon me gëzim e hare.

Kur afrohen afër, njerëzit e familjes së nuses dalin dhe i presin me mjaft bujari. Këta hyjnë në dhomë, përshëndeten ulen i shërbejnë me cigare etj. Si te të gjithë shqiptarët edhe te ne, dhëndri dhe shokë e tij kanë me vete nga një pako cigare për njerëzit e pranishëm. Pra, me radhë ua ofrojnë pakot me cigare shërbyesve e ata me radhë ua shpërndajnë burrave të familjes, duke u thënë se cigaret janë të filanit dhe kështu vazhdon muhabeti. Dhëndri flet më së paku edhe pse e ngucin më shumë. Pas pirjes së lëngjeve dhe çajit, vjen koha e drekës.

Pasi lajë duart shtrohet sofrabezi e pastaj edhe sofra. Ulen dhëndri me shokë, ulen edhe të tjerë. E ceka edhe më herë se dreka është shumë “e majme”. Si zakonisht fillon me çorbë për të vazhduar me paçë (lloj byreku, specialitet i Luginës) fasule, jani, mish me oriz, pite, bakllava, e në fund edhe tomëloriz (sytliaç) . Nganjëherë pas sytliaçit qesin edhe sarëm (japarak). Gjatë drekës vazhdimisht dhëndrin e ngucin me fjalë. Kur hahet bakllavaja dhëndri i lë disa të holla në tepsi të bakllavasë. (rreth 100-200 marka gjermane).

Pasi të drekojnë , i lajnë duart dhe i ndezin cigaret. Thamë edhe më herët, se zakonisht e ngacmojnë dhëndrin me fjalë. Gjithnjë në mbrojtje e merr personi më i moçëm, që ka ardhur me dhëndrin.

Ndërkohë, një burrë nga familja e nuses, në mënyrë alegorike e pak me humor thotë, se neve na kanë mbetur do dru për t'i prerë, apo edhe që ta qesim plehun etj.

e na nevojitet për një kohë dhëndri. Njerëzit e dhëndrit u japin leje, por me kusht që mos ta mundoni shumë, kuptohet edhe këta e kanë me humor. Kështu, udhëheqësi i grupit, me ndonjë tjetër dhe dhëndri dalin TE **GJYSHJA**, te dhoma tjetër. Aty, përveç vjehrrës (gjyshes) janë edhe dy-tri gra tjera. Te ne është zakon që atë ditë, dhëndri të shërbehet edhe me petulla. Pra, të pranishmit hanë petulla dhe nga pak edhe bisedojnë, pra në një mënyrë edhe e testojnë dhëndrin se a është i mençur. Ky është edhe takimi i parë dhëndrit me gjyshen. Pas disa bisedash, kërkohet leje për të dalë. Në dalje sipër dhëndri i lë të holla gjyshes dhe grave tjera. Në dhomë e burrave i presin me gëzim e hajgare. Biseda vazhdon. Pas pak, ai që është si udhëheqës, kërkon leje (lyp izën) që të ikin. Leja u jepet. Në oborr të nuses rëndomë luajnë disa djem rreth 7-8 vjeç. Dhëndri atyre u hedh para, monedhe të metalta. Fëmijët, të gëzuar, i mbledhin paratë. Kështu dhëndri me shokë përshëndeten me mikpritësit dhe vazhdojnë rrugën për në shtëpi.

Në shtëpinë e dhëndrit, përafërsisht e dinë kohën se kur kthehet dhëndri dhe kështu e veshin nusen me petka të mira dhe ajo del për ta pritur dhëndrin. Bisedat vazhdojnë.

Duhet ta përmendim, se pikërisht gjatë kësaj dite bëhet edhe mbledhja e çejzit. Pra, paja një javë rri shtrirë.

Tash ka mbetur edhe SHKUARJA BABXHYSH. Pas disa ditësh duhet që babai i nuses me disa burra të farefisit dhe dajallarët e nuses të shkojnë te familja e dhëndrit. Këtu shkojnë njerëzit e moshuar, me përjashtim mundet edhe ndonjë vëlla i nuses. Rëndomë shkojnë rreth 11 veta, por s'është numri fiks. Më herët njerëzit, që kanë shkuar babagjysh kanë bujtur dy net e dikur një natë e më vonë edhe kthyesëm. Këta njerëz priten si është më së miri, sidomos me cigare janë plot e përplot. Cigare shpërndajnë edhe të ardhurit. Madje, miqtë cigaret nuk i ndezin vetë, po ua ndez dhëndri, i cili tërë kohën rri në këmbë. Edhe këtu ka qenë darka “prej çorbës e deri në Bakllavë...” Te ne thuhet “Për babgjysh zifafeti duhet deri n’gu...”

Shkuarja SË PARI

Pas një muaji, familja e vajzës vijnë ta marrë, vajzën e tyre së pari. Zakonisht vjen me qerre vëllai, apo mixha i nuses me dy-tri gra.

Familja e burrit pos drekës, përgatisin edhe shumë kuleç, bakllava për mixhallarët e nuses edhe ndonjë tatli, apo ëmbëlsirë tjetër. Pasi hanë drekë, nisen dhe kthehen në shtëpi. Në shtëpi i presin me qejf. Nëpër mëhallë shpërndajnë nga një kulaç dhe nga një copë bakllavë. Pas një jave, familja e burrit vijnë për të marrë nusen.

Zakonisht , me qerre shkon kunati apo mixha me dy-tri gra. Shtëpia e vajzës bëhen gati. Pos drekës, edhe këta bëjnë bakllavë dhe kuleç. Pas drekës kthehen në shtëpi. Edhe në shtëpinë e burrit, nëpër mëhallë. shpërndajnë nga një kulaç dhe nga një copë bakllavë. Kështu edhe mbarojnë ceremonitë e dasmës në Luginën e Preshevës.



Limon (Staneci) dhe Miradije Asllani gjatë dasmës dhe një ditë pas dasmës në vitin 1930. Zonja Miradije edhe sot është gjallë.

L i t e r a t u r a:

Antoni Lorenc, Folklori muzikor shqiptar, bleni V. Prishtinë: 1972.

Antoni Lorenc, Folklori muzikor shqiptar, bleni VII. Prishtinë: 1977.

Cetta Anton, Nga folklori ynë. Prishtinë: 1995

Dauti Zeqirja Lojra popullore nga Kosova Lindore, Gjilan: 2009

Dr. Staneci Jahi, Legjenda e Karadakut: 2007.

<https://www.facebook.com/Presheva-me-rrethin%C3%AB-1721741471396531/>

Instituti Albanologjik i Prishtinës. Këngë Dasme I. Prishtinë: 1980

Instituti Albanologjik i Prishtinës. Këngë Dasme II. Prishtinë: 1982

Instituti Albanologjik i Prishtinës. Këngë Dasme III. Prishtinë: 1984

Kajtazi Halil, Nga lirika popullore e Drenicës. Prishtinë: 1972.

Krasniqi Mark, Mikpritja në traditën shqiptare, Prishtinë 2005

Mr. Pireva Bislim. Këngët dhe ritet e martesës në Malësinë e Kamenicës. Prishtinë: 1996.

Qendra për hulumtime shkencore e Fakultetit Pedagogjik të Universitetit të Evropës Juglindore - Tetovë, 2006, 204 faqe.

Shala Demush, Këngë popullore lirike, Prishtinë.

Xhaferi Hamit, Studime nga krijimtaria gojore shqiptare në Maqedoni, Interlingua, Shkup, 2010.

Xhaferi Hamit, Dallimet gjuhësore midis gjinive dhe figurave e gruas në poezinë popullore. Tetovë: 2006.

Xhaferi Hamit, Studime dhe trajtesa nga letërsia gojore, Shtëpia botuese Interlingua, Shkup, 2005, 186 faqe.

Xhaferi Hamit, Dallimet gjuhësore midis gjinive dhe figura e gruas në poezinë popullore,

Zeqiri Mumin. Lirika popullore e dasmës në Luginën e Kumanovës. Kumanovë: 1993